

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7820 E enjte 14 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga JORGJI KOTE



Zgjedhjet europiane,
sondazhet dhe negociatat

Vetëm 70 ditë na ndajnë nga 23/26 maji, kur në të 27 vendet anëtare të BE-së do të zhvillohen zgjedhjet e reja për 700 vende në Parlamentin Evropian. Kjo ...
Vijon në faqen 20

Opinion

Ditës

Nga NERITAN SEJAMINI



Nevoja për një strategji të ndershme të opozitës

Përballë krizës politike, kryeministri Edi Rama ka zgjedhur "strategjinë e normalitetit": të ruajë pushtetin duke krijuar dukjen e një qeverisjeje ...
Vijon në faqen 21



Kreu i PD: Ka nisur numërimi mbrapsht

Basha: Rama dhe dy ministra blenë vota. Kryemadhi: Deputetët "rebelë" s'janë të LSI

Deputetët e listës së opozitës shkojnë në 14. LSI-ja, Kokës: Përfiton nga parlamenti i krimt

Nga VALENTINA MADANI

Me afrimin e protestës së 16 marsit në orën 11:00 para Kryeministrit, lideri i opozitës, Lulzim Basha, ka nisur numërimin mbrapsht për largimin e kryeministrit Edi Rama. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", Basha përkrah ...
Në faqen 2-4

TABELAT ME SHEMBUJT KONKRETE NE BAZE TE VJETERSISE DHE VITEVE TE PUNES

PENSIONET, UDHEZIMI PER TE MESUAR MASEN E PERFITIMIT

Ekspertja Beskida Aliaj shpjegon si bëhet përlllogaritja e masës së përfitimit të pensionit të pleqërisë. Koeficientët e indeksimit të pagave që nga '93



(Në foto) Pensionistë (Foto ilustruese)

Në faqen 10-11

KRYEMINISTRI

Zaev në Tiranë,
Rama: Rusia nuk është tifoze e zgjerimit të BE-së

Në faqen 5

VETINGU

Fshehu dënimin për vjedhje, merret i pandehur ish-gjyqtari i Gjykatës së Lartë

Në faqen 8

TAKSAT

Ambasadori i BE, Soreca: Monitorim tenderave, kujdes me paratë publike

Në faqen 7

VRASJA E TREFISHTE

Masakra tek "Zogu I", Apeli: Burg përjetë për vrasësin italian Salvatore Letizia

Në faqen 9

LISTA E RE



Dosjet e pronave, 6 mijë emrat që iu njihet e drejta për kompensim financiar

Në faqen 14-16

Publikohet raporti i DASH, Vasili: Amerika i vuri vulën shitblerjes së votës

SHBA: Zyrtarët e lartë shmangën ndjekjen penale

"Presion ndaj gazetarëve, shtëpia e Klodiana Lalës u qëllua 10 herë"

Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) publikoi dje raportin mbi të drejtat e njeriut në botë. Në pjesën për Shqipërinë trajtohen një numër çështjesh. Ja disa prej tyre: Mosdëshkimi mbeti problem. Ndjekja penale dhe sidomos dënimet e zyrtarëve që kryenin abuzime



ishte sporadik dhe jokonsistent. Zyrtarët, politikanët, gjyqtarët dhe personat me interesa të fuqishme biznesi shpesh ishin në gjendje të shmangnin ndjekjen penale. Në përgjigje të kësaj, autoritetet kanë ndërmarrë një veting të ...
Në faqen 17

OPOZITA E RE PERPLASJA

Valentina Madani

Komiteti Drejtues Ko mbëtar i LSI-së ka vendosur që të çregjistrojë nga regjistri i anëtarësisë të gjithë kandidatët e listës së saj që marrin mandatin e deputetit. Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, me një letër drejtuar KQZ-së i bën me dije këtë institucionin se çdo mandat i dhënë nga lista shumemërore e Lëvizjes Socialiste për Integrim është antikushetues. Sipas saj, vetëm LSI nga autoriteti që i jep Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor ka të drejtë të zgjedhë nga lista përfaqësuesit e saj në parlament. "Çdo individ i listave shumemërore të LSI, që pranon mandatin e deputetit nuk përfaqëson as formalisht as ligjërisht dhe as politikisht LSI, ndaj edhe dhënia e mandatit çdo njërit prej tyre është antikushetuese dhe antiligjor, pasi në zgjedhjet politike të 25 qershorit në përputhje me Kushtetutën dhe Kodin Zgjedhor, qytetarët shqiptarë kanë votuar për partitë politike dhe jo për individët. Rezultati i arritur nga LSI i ka dhënë kësaj partie të drejtën ligjore që në përputhje me ligjin të zgjedhë nga lista shumemërore e LSI përfaqësuesit e saj në parlament, bazuar në radhitjen në listën shumemërore, të vendosur po nga LSI si parti politike, sipas autoritetit të përfaqësimit, që i jep asaj Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor", shprehet Kryemadhi. Ajo bën me dije se: "Çdo mandat i dhënë nga KQZ-ja nga lista shumemërore e LSI nuk përfaqëson absolutisht këtë parti. Çdo individ, që pajiset me mandat deputeti nga KQZ nga kjo listë shumemërore e LSI është i paligjshëm dhe nuk mund të përdorë në asnjë rast as vullnetin politik, por as atributet formale, ligjore dhe publike të përfaqësimit të Lëvizjes Socialiste për Integrim përfshirë këtu siglën, programin, statutin, emblemen, vullën dhe emrin e Lëvizjes Socialiste për Integrim".

DEKLARATA

Edhe pse doli kundër vendimit të LSI-së për të mos dorëzuar mandatin, deputeti Lefter Koka shprehet se vazhdon të jetë pjesë e LSI. Në një deklaratë për mediat nga jashtë parlamentit, ai tha se marrëdhëniet me kryetarin e LSI, Monika Kryemadhi janë shumë të mira. "Kanë qenë dhe janë marrëdhënie shumë të mira", theksoi z.Koka. Sipas tij, fajin për gjithë këtë paradokse e ka Kodi Elektorale, pasi deputetët dalin nga listat e partive dhe jo nga qytetarët. "Të gjithë në emër të popullit kanë marrë një vendim. Disa të mos e dorëzojnë mandatin, disa të tjerë për ta marrë dhe disa për t'u larguar. Sig-

LSI heq nga lista "tradhtarët": Nëse KQZ u jep mandatin, shkelet Kushtetuta

Përplasja, Kryemadhi: Mandati i paligjshëm, Koka: Mbetem i LSI-së

Fluksi i marrjes së mandateve, letra për KQZ-në



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi dhe deputeti Lefter Koka

MONIKA KRYEMADHI

"Çdo individ i listave shumemërore të LSI që pranon mandatin e deputetit nuk përfaqëson as formalisht, as ligjërisht dhe as politikisht LSI-në, ndaj edhe dhënia e mandatit çdo njërit prej tyre është antikushetuese dhe antiligjore", tha zj.Kryemadhi.

LEFTER KOKA

"Të gjithë në emër të popullit kanë marrë një vendim. Disa të mos dorëzojnë mandatin, disa të tjerë për ta marrë dhe disa për t'u larguar. Jam pjesë e LSI, nuk kemi pasur nga ai moment ku vendimi im ishte i ndryshëm nga ai i grupit parlamentar".

"Zgjedhe të përfitosh nga parlamenti i krimit"

"Kam marrëdhënie të mirë", LSI i përgjigjet Kokës: Je peng i mëkateve

Pas deklaratave të Lefter Kokës që ka marrëdhënie të mirë me Kryemadhin, vjen edhe reagimi i LSI. Në kuadrin e sekretarit të përgjithshëm, Endrit Braimllari shprehet se Koka është i vetërefuzuar prej kohësh në mbledhjet e grupit parlamentar dhe të kryesisë së LSI-së. Braimllari rendit edhe veprimet rrebe të Kokës, ndërsa shkruan se LSI nuk do jetë peng i interesave private. "Lefter, po të sqaroi si sekretar i përgjithshëm se me veprimin tënd je i vetëpërfuzuar, pasi ke refuzuar që prej kohësh të marrësh pjesë në



mbledhjet grupit parlamentar dhe të kryesisë së LSI. LSI vendosi të mos jetë pjesë e parlamentit të komanduar nga kriminelët dhe të paguar

prej parave të drogës. Ndërsa ti ke zgjedhur të rrihsh aty dhe të përfitosh prej tij dhe kjo është zgjedhja jote dhe jo e LSI. Sa ishte pjesë e LSI, nuk vije në parlament, sot vendose të shkosh. LSI nuk do të jetë peng e interesave private të asgjë, as të djegies së mëkateve në inceneratorë, por do luftojë deri në fund që Shqipërinë ta qeverisin shqiptarët dhe jo kriminelët. Kushdo në Shqipëri të përgjigjet përpara ligjit deri në fund për çdo abuzim apo përvetësim të parave të qytetarëve shqiptarë", shprehet z. Braimllari.

urish që jam pjesë e LSI-së, nuk kemi pasur nga ai moment ku vendimi im ishte i ndryshëm nga ai i grupit parlamentar. Ne me të vërtetë propozohemi nga një forcë politike, sepse ashtu është kodi, por secili në momentin që zgjidhet përfaqësohet në parlamentin shqiptar", tha z.Koka. Ai njoftoi se është gati të votojë reformën zgjedhore, por me kusht që të bëhen disa ndryshime të tjera, pasi nuk është i plotë. "Ajo që është për të thënë dhe

besoj që kërkon vëmendje të madhe nga anëtarët e parlamentit është riparja e Kodit Zgjedhor. Sot jemi kthyer qesharakë për shkak të këtij kodi. Nëse do të vazhdojnë deputetët t'u binden kryetarëve të partisë për t'i emëruar apo shkarkuar, unë mendoj se ky parlament do humbë funksionin e tij. Ndaj, çdo nismë që do të bëjë përfaqësimin e qytetarëve shqiptarë në një mënyrë sa më të drejtë, do të ketë mbështetjen time dhe të deputetëve

të opozitës", u shpreh deputeti Koka. Por, ndryshe nga Koka mendon LSI, pasi Komiteti Drejtues Kombëtar i kësaj partie ka vendosur të heqë nga lista të gjithë kandidatët e regjistruar për zgjedhjet e 2017, të cilët thejnë vendimin politik duke marrë mandatin e deputetit. 8 kandidatë që vijnë nga lista e LSI-së kanë marrë mandatin e LSI-së dhe dy të tjerë kanë dorëzuar formularin e dekriminalizimit në KQZ për të nisur procedurën për marrjen e mandatit.



JORIDA TABAKU

Ish-deputetja Jorida Tabaku e cilësoi si parodinë e radhës që prodhon qeverisja "Rama", shfaqjen e komedisë që prodhoi sot parlamenti i krimit, që sipas saj nuk përfaqëson më shqiptarët. "Propaganda e qeverisë ka rënë, perdia është grisur dhe sot parodia në Kuvend tregoi se në fakt ai është thjesht parlamenti i krimit dhe nuk përfaqëson shqiptarët! Patericat e krimit nuk mund të përfaqësojnë opozitën dhe opozitarët", tha Tabaku.

SHKURTE

Ironia e të rinjve të PD: Ftesë për 'synellëk'

Në Kuvend dje u betuan deputetët e rinj të opozitës, por jashtë sallës të rinj të Forumit Rinor të PD-së ironizuan përmes fletushkave deputetët e opozitës së re. Më pas, një drom në të cilin ishte lidhur një banderolë me mbishkrimin "Parlamenti i krimit" fluturoi mbi godinën e Kuvendit. Megjithatë nuk ishte parajlmëruar asnjë protestë nga ana e opozitës, policia e Tiranës mori gjithë masat për të shmangur ndonjë incident të mundshëm. Ishin gjithësej rreth 300 punonjës policie në ruajtje të parlamentit, forcat "Shqiponja" dhe FNSH. Edhe pse nuk u zhvillua një protestë e mirëfilltë, ata me forma të ndryshme shprehën kundërshtinë ndaj qeverisë së Ramës. Droni me mbishkrimin "Parlamenti i krimit" qëndroi për disa momente në hyrje të parlamentit. Më herë ata hodhën shashka në oborrin e parlamentit. Ndërsa mëngjesin e djeshëm pranë parlamentit kanë ngjitur disa pankarta me mesazhe politike kundër deputetëve të rinj të opozitës. Ata kanë ngjitur disa pankarta pranë parlamentit "Ftesë për synellëk. Kemi kënaqësinë t'ju ftojme në festën e synellëkut, të djalit tonë Ligoraj Karamelo. Berber: Edi Rama. Dhuratë për synellëk, 300 mijë euro e lart".

PD: Regjimi ushtarak i Ramës, frikë nga populli

Demokratja Albana Vokshi publikoi dje në "Facebook" disa foto të marrjes së masave të sigurisë nga policia dhe përreth parlamentit. Ajo shkruan se parlamenti është nën rrethim nga mijëra forca policie, pasi regjimi ushtarak i Ramës ka frikë nga populli. "Tirana edhe sot (dje) në shtetërrhim për karrigen e Edi Rames. Mijëra policë e autobllinda kanë mbushur rrugët si në shtetërrhim. Edi Rama po qeveris me regjim ushtarak! Dhe kjo është dëshmia e fundit e diktatorëve. Askush nuk do ta pranojë më këtë regjim, sepse shqiptarët i kujtojnë siç ata dinë agresorët e lirive të tyre!", tha zj.Vokshi. Ajo i kujton Ramës se deputetët që mbrohen nga populli s'mund të jenë asnjëherë përfaqësues të tij.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafille VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llake Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0688087823-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës

së Autotransportëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



Maliqi ulet në karrigen e Lulzim Bashës: Brenda dy muajve plotësohet opozita

Betohen 7 deputetët e rinj, opozita e re me 14 mandate në Kuvend

Shkon në 93 numri i deputetëve në parlament

Ka mbërritur në 14 numri i opozitës së re në Kuvend. Dje është betuar grupi i dytë i deputetëve që kanë marrë mandatin rishtazi, ndërsa dy kandidatë të tjerë janë në pritje të marrjes së mandatit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Lefter Maliqi, Alban Zeneli, Ligoraq Karamelo, Majlinda Halilaj, Ediola Braha, Edlira Hyseni dhe Elda Hoti u betuan në seancë e djeshme, ku morën edhe durtrokitjet e deputetëve socialistë. Majlinda Halilaj ka marrë mandatin e kryetarit të PD-së, Lulzim Basha; Lefter Malizi zëvendëson Astrit Veliqin; Ligoraq Karamelo zëvendëson Ervin Salianin, ndërsa Alban Zeneli Flamur Nokën, të gjithë nga listat shumemërore të PD-së. Ndërkohë që 3 deputetë të tjerë vijnë nga radhët e LSI-së. Më konkretisht, Elda Hoti zëvendëson Viktor Tushaj, Edlira Hyseni zëvendëson Nora Malajn dhe Ediola Braha zëvendëson Vangjel Tavon. Fill pas betimit, deputeti Lefter Maliqi, i cili u ul në karrigen që më parë qëndronte Lulzim Basha, duke marrë fjalën në Kuvend u shpreh i sigurt se të gjitha vendet që i përkasin opozitës do të plotësohen nga listat shumemërore të PD dhe LSI dhe se opozita do jetë e plotë. "Pata këmbën e mbarë, fati që zura dhe vendin e kryetarit me mandat të dhuruar të PD-së dhe jam i bindur që brenda dy muajve rreshti këtëje nga opozita do të jetë plot. Të mos kujtojnë ata që kanë dalë jashtë se janë më të mirë se ne që jemi këtu. Duhet t'u drejtohem të gjithë demokratëve që gënjejn nga kryetari me mandat të dhuruar që ëndërron të bëhet kryeministër me dhurata, por kryeministër mund të bëhet vetëm me vota", - tha Lefter Maliqi.



Deputeti Lefter Maliqi dje në parlament

OPOZITA

"Pata këmbën e mbarë, fati që zura dhe vendin e kryetarit me mandat të dhuruar të PD-së dhe jam i bindur që brenda dy muajve rreshti këtëje nga opozita do të jetë plot. Të mos kujtojnë ata që kanë dalë jashtë se janë më të mirë se ne që jemi këtu. Duhet t'u drejtohem të gjithë demokratëve që gënjejn nga kryetari me mandat të dhuruar që ëndërron të bëhet kryeministër me dhurata, por kryeministër mund të bëhet vetëm me vota", - tha Lefter Maliqi.



Duka uron Ralf Gjonin: Do jesh ndër më të diturit në parlament

Ndonëse është pjesë e tryezës së kryetarëve të opozitës, Agron Duka nuk e ka pasur aspak problem që ta urrejë Ralf Gjonin për vendimin për të marrë mandatin e deputetit dhe për t'u futur në parlament, pavarësisht se është një vendim që bie ndesh me vendimin politik të opozitës për të djegur mandatet. Duka e ka urrear atë publikisht, ndërsa nuk nguron ta cilësojë atë si një nga njerëzit më të ditur dhe integritet të parlamentit aktual. "Vendimi është i yti, por për një gjë jam i sigurt që do jesh një ndër më të diturit e me më integritet në atë parlament. Të paktën ngushëllohem që ka edhe njerëz që e meritojnë parlamentin, ndoshta duhet të ishe në listat fituese, por ky është defekt i këtij sistemi të përcjelluar. Sukses!", - shkruan Duka. "Agron Duka, mikui im të falënderoj nga zemra dhe e vlerësoj mbështetjen tënde. Do u qëndroj besnik parimeve dhe të kaluarës sime. Shpresoj të shihemi së shpejti", - u përgjigj Gjonit.

NJOFTIM ANKANDI

Përmarruesi Gjyqësor Privat Neritan Çuko, në datën 20.03.2019 ora 16:00 zhvillon ankandin e Parë, për shpëtimin e pasurisë së paluajtshme të lojit "Apartamenti me sipërfaqe 85 m², me numër pasurie 410/168/ND-1-19, në volum 1, faqe 110, hyrja 1, apartamenti 19, në zonën kadastrale nr. 2832, në Vlorë, në pronësi të Albert Sali Troqe, me debitor Tonin Troqe. Çmimi fillues me të cilin fillon ankandi është EUR 23.200 (njëzetë e tremije e dy mijë euro). Për çdo informacion mund të kontaktoni: Cel: Neritan Çuko: 0686065334; E-mail: neritancuko@gmail.com.

Kuvendi shpërndan deputetët e rinj në grupet parlamentare

Ndonëse partitë kryesore opozitare i kanë konsideruar tradhtarë dhe njerëz që nuk i përfaqësojnë më, Kuvendi i Shqipërisë i ka shpërndarë deputetët e rinj në grupet ekzistuese parlamentare sipas listave të partive që kanë qenë. Kështu, në faqen zyrtare të Kuvendit vërehet se grupi parlamentar i LSI-së përbëhet aktualisht nga katër deputetë, ku veç, Lefter Kokës janë bërë pjesë edhe 3 deputetë të tjerë të rinj. Bëhet fjalë për Ylli Shehun, Aurora Marën dhe Edmond Rushin. Ndonëse ata s'kanë marrë konfirmimin e kryetarit të grupit parlamentar, Kuvendi i ka vendosur t'i caktojë ata në grupin e LSI-së. Neni 15 i Rregullores së Kuvendit, që flet për formimin e grupeve parlamentare përcakton se deputetët mund të formojnë grupe parlamentare sipas përkatësisë partiake ose orientimit politik. Sipas kësaj rregulloreje, një deputet që largohet nga grupi parlamentar mund t'i bashkohet një grupi tjetër parlamentar vetëm pas gjashtë muajve nga data e largimit. Çdo deputet deklaroi me shkrim se në cilin grup parlamentar bën pjesë. Vetëm deputetët që nuk bëjnë deklarinë e mësipërme ose që nuk i përkasin asnjë grupi parlamentar mund të formojnë grup të përzier. Ndërkohë që deputetët që zgjidhen gjatë legjislaturës, brenda 3 ditëve nga kryerja e betimit, bëjnë deklarinë me shkrim se cili grup parlamentar i përkasin. Pra, siç përcaktohet në këto dispozita, rregullorja ua ka lënë në dorë vetë deputetëve të përcaktojnë me kërkesë se në cilin grup do bëjnë pjesë



Tjetër rrjedhje nga LSI, Nimet Musai pranon mandatin e deputetit

Përveç Ralf Gjonit, që pret të marrë mandatin e deputetit nga KQZ-ja, një tjetër kandidat nga listat e Lëvizjes Socialiste për Integrim ka pranuar të futet në Kuvend. Ai është Nimet Musai nga lista shumemërore e LSI-së për qarkun Fier, i cili nuk ka humbur kohë dhe ka dorëzuar formularin e dekriminalizimit, duke konfirmuar marrjen e mandatit të Erisa Xhixhos. Kujtojmë se Musai vjen nga radhët e komunitetit çam dhe më parë ka kandiduar edhe si pjesë e koalicionit të djathtë. Bashkë me të shkon në 9 numri i kandidatëve nga radhët e LSI-së, që kanë pranuar të marrin mandatin e deputetit.



që ishin këtu", - u shpreh Maliqi. Ndërkohë që deputeti tjetër i ri, Ligoraq Karamelo u shpreh se opozita e re po organizohet për të vepruar si një grup i përbashkët, të cilin do t'i bashkohen edhe deputetë të tjerë. "Ne hodhëm hapin e parë. Organizim do të thotë që duhet të funksionojmë si një opozitë e përbashkët, e vendosur, që të mbajmë një qëndrim bashkëpunues me mazhorancën, por edhe

kundërshtues, demaskues ndaj problemeve të korrupsionit dhe mbi të gjitha një opozitë që respekton parimet themelore demokratike, Kushtetutën. Do të presim edhe deputetët të tjerë dhe do kemi një opozitë shumë aktive në parlament", - u shpreh Karamelo. Ndërkohë që pavarësisht se e konsiderojnë veten opozitarë, ata mbështetën dje me votë nisimat e qeverisë. Kështu, katër nga

shatë deputetët e rinj që u betuan votuan por projektligjit për nxitjen e punësimin, një kundër, një abstenim dhe njëri nuk ishte i pranishëm. Me prurjet e reja, Kuvendi ka shkruar me 93 deputetë, numër i mjaftueshëm ky për të ndryshuar edhe Kushtetutën, ndërkohë që shumë shpejt pjesë e tij do bëhen edhe dy deputetë të tjerë opozitarë, që presin të marrin mandatin në KQZ.

PROTESTA TAKIMET

Dozja '184', kreu i PD publikon emrat: Kryeministri me dy ish-ministra blenë vota

Valentina Madani

Me afrimin e pro testës së 16 marsit në orën 11:00 para Kryeministrit, lideri i opozitës, Lulzim Basha, ka nisur numërimin mbrapsht për largimin e kryeministrit Edi Rama. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", Basha përkrah fotos së flamurit kombëtar në sfond njofton ndjekësit e tij të shumtë se ka nisur numërimin mbrapsht, duke u kujtuar atyre datën dhe orën e protestës. Më herët, kreu i PD-së ishte në Dibër nga ku ftoi qytetarët e këtij qarku për një pjesëmarrje masive në protestën e 16 marsit. I prit me thirrjet "Rama ik", Basha përmendi se Dibra dhe dibranët "e kanë vranë frikën të parët dhe kanë ndezur shpresën për t'i prirë të parët marshimit të pandalshëm për rrëzimin e qeverisë së krimit dhe krye hajdutit Edi Rama". Lideri Basha u kërkoi dibranëve të bashkohen në protestën e së shtunës para Kryeministrit. "Dibrës i takon të jetë në krye të kësaj beteje, sepse Dibra ishte kurbani i parë i bashkimit të Edi Ramës me kriminelët, me trafikantët e drogës dhe të vajzave dhe grave", theksoi kreu i PD-së. Basha gjatë turit në Dibër u takua me tregtarë dhe biznesmenë të ndryshëm, ku u premtoi se qeveria demokratike do t'u ulë taksat dhe tatimet. Gjatë bashkëbisedimit me tregtarë dhe banorë të zonës, Basha kërkoi ndihmën e dibranëve për të çliruar vendin nga kriminelët dhe hajdutët në pushtet.

DOZJA

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, paralajmëroi dje nga Dibra se dozja '184' është fundi politik i Edi Ramës. Z.Basha akuzoi me emra konkretë për blerje votash në zgjedhjet vendore të 2016-ës. Sipas tij, dosja hetimore '184' përmban fakte kompromentuese për dy ish-ministra të qeverisë "Rama". Basha akuzoi se ka fakte që Rama dhe deputetë socialistë janë investuar në blerje votash, por dosja po mbahet qëllimisht e fshehtë nga kryeprokurorja Arta Marku. Nga Dibra, lideri i opozitës zbuloi emrat e dosjes '184'. Sipas tij, janë përgjuar në blerje votash dhe kontakte me Ymer Lalën dhe dy ish-ministra të qeverisë "Rama", si Damian Gjinknuri dhe Arben Ahmetaj. Ai përmendi edhe disa emra deputesh të rëndësishëm në qarqet e veriut të vendit, të cilët janë përfshirë në negociatat për mbushjen e kutive të votimit. "Dozja 184 është fundi politik i Edi Ramës dhe bandës së tij të hajdutëve. Në këtë dosje janë kapur gafil Edi Rama, Damian Gjinknuri, Ulsi Manja, Sadri Abazi, Pjerin Ndreu, Paulin Sterkaj dhe

Protesta e 16 marsit, Basha: Ka filluar numërimi mbrapsht

"Rama dhe Ymer Lala, bashkë në qelinë e burgut 313"



dhetëra të tjerë socialistë, duke bërë pazare me Ymer Lalën e krimin e organizuar për të blerë vota dhe shantazhuar dibranët dhe mbushur kutinë e votimit. Prokuroria kriminale e Arta Markut dhe e Donika Prelës e mbajnë të fshehur dosjen, por dosja

nuk do fshihet përgjithmonë. Edi Rama dhe Ymer Lala kanë shumë qejf të rrinë bashkë dhe kur të zbardhet dosja, bashkë do të rrinë në qelinë e burgut 313, aty ku e kanë vendin të gjithë ata që kryejnë vjedhjen e votave", u shpreh z.Basha. Ai akuzoi se në push-

SHITBLERJA
Z.Basha akuzoi me emra konkretë për blerje votash në zgjedhjet vendore të 2016-ës. Sipas tij, dosja hetimore '184' përmban fakte kompromentuese për dy ish-ministra të qeverisë "Rama". "Janë përgjuar në blerje votash dhe kontakte me Ymer Lalën dhe dy ish-ministra të qeverisë 'Rama' si Damian Gjinknuri dhe Arben Ahmetaj. Rama dhe biznesmeni dibran, Ymer Lala, do të përfundojnë të dy në qelitë e burgut", tha z.Basha.

tet është krimi, jo e majta. Basha i ftoi qytetarët që t'i bashkohen protestës për ta hequr nga pushteti këtë qeveri kriminale. "Më 16 mars të na bashkohesh në protestë që të shembim këtë qeveri të krimit dhe hajdutërisë, që t'i japim mundësinë të punojnë me liri dhe dinjitet. Ne mandati i dogjëm për të qenë në krahun e qytetarëve, jo në krahun e krimit, jo në krah të Ymer Lalës. Kam folur me akte, jo me fjalë", u shpreh kreu i PD-së.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në Peshkopi

Denoncimi i turistit të Berisha: Policia më mori 90 euro

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje mesazhin e një shqiptari të Kosovës, i cili ka zgjedhur vendin tonë si destinacion turistik. Në mesazhin dërguar Berishës, qytetari nga Prishtina shkruan se policia i mori rreth 90 euro në ndalesat e bëra. Pyetja që ai ka në mesazh është a do ketë fund kjo gjë për të. "Ja ku e ka katandisur Shqipërinë regjimi i kaktokracisë të Edvinit dhe klikës së tij. Narkopolicia ndalon turistin 11 herë gjatë rrugës. Lexoni mesazhin e turistit dixhital. 'Jam një djalë nga Prishtina. Për herë të parë këtë vit vizitova Tiranën, por u bëra shumë pishman pse erdha në Tiranë. Gjatë rrugës 11 vende më ndali policia. Prej tunelit e deri në Tiranë më morën 90 euro. A është kjo e drejtë që policia e një shteti të bëjë një gjë të tillë? Pse ndodhin këto gjëra me policin shqiptarë? Deri kur të na malltretoj rrugës dhe kërkojnë euro nga ne, deri kur?"; - thuhet në mesazhin drejtuar z.Berisha.



"E gabuar, të rreshtohesh përkrah Ramës"

Hajdari s'la mandatin, Noka: Azemi s'do ta bënte një gjë të tillë

Ish-deputeti i PD-së, Flamur Noka, deklaroi dje nga Shkodra se më 16 mars do jetë fundi i qeverisë dhe se me 17 për Shqipërinë do të nisë një histori e re. Noka takoi bizneset e qytetit, duke iu bërë thirrje për të marrë pjesë në protestën e 16 marsit. Lidhur me pranimin e mandateve të deputetëve të PD si Lefter Maliqi, Noka u shpreh se Edi Rama ashtu siç ka blerë votat, ashtu po blen edhe mandatet. Ish-deputeti i PD-së duke komentuar "mosbindjen" e Rudina Hajdarit për të dorëzuar mandatin, deklaroi se ajo ka folur vetë dhe se të rreshtohesh përkrah Edi Ramës është gjëja e gabuar. Sipas Nokës, po të ishte Azem Hajdari gjallë s'do ta kishte bërë një gjë të tillë. Për ministrin Lleshaj, i cili ka deklaruar se gazi lotsjellës është blerë që në kohën e Berishës, Noka u shpreh se Lleshaj duhet të flasë me mendjen e tij dhe jo t'ia marrë "password"-in e trurit kryeministrit. "Kam ardhur për t'u bërë thirrje për protestën më 16 mars. Të gjithë në Tiranë, për të rrezuar këtë bandë kriminale. Taksat besoj ua ka rritur. Xhiro biznesi nuk ka", tha z.Noka.

DEKLARATA

Z.Noka teksta foli për "mosbindjen" e Rudina Hajdarit për të dorëzuar mandatin, deklaroi se ajo ka folur vetë dhe se të rreshtohesh përkrah Edi Ramës është gjëja e gabuar.

United Nations Development Programme



TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: RFQ - "IT Equipment – to be used in public service delivery one stop shops at the municipal level where ADISA, the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania, will be setting up its multifunctional collocated service windows for central government"

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked UNDP Procurement Notices 54003 - RFQ - "IT Equipment – to be used in public service delivery one stop shops at the municipal level where ADISA, the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania, will be setting up its multifunctional collocated service windows for central government".

For more details please refer to the link below: http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=54003

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than March 27, 2019, 14:30 p.m.

Address for communications: Email: procurement.al@undp.org

Or Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor Tirana, Albania



Open Regional Fund Foreign Trade Promotion (ORF FT)

As an international cooperation enterprise for sustainable development with worldwide operations, the federally owned Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH supports the German Government in achieving its development-policy objectives. It provides viable, forward looking solutions for political, economic, ecological and social development in a globalised world. GIZ promotes complex reforms and change processes. Its corporate objective is to improve people's living conditions on a sustainable basis.

Background of the project

The Open Regional Fund Foreign Trade Promotion (ORF FT) aims to improve framework conditions for free trade and competitiveness through the promotion of regional cooperation. The ORF FT is implemented through sub-projects with partners from three or more countries from the region. The sub-projects are aimed at eliminating barriers to trade, improving trade procedures on the national level, strengthening institutional capacities for implementing trade-relevant regional agreements (Central European Free Trade Agreement, CEFTA and Stabilization and Association Agreements) and improving services for trading businesses.

Further information on the program can be found at <https://www.giz.de/en/world-wide/20321.html>. The ORF also acquired co-financing from the European Union as of January 01, 2017 for a period of 3 years. The EU-financed component "Support to Facilitation of Trade between CEFTA Parties" forms part of the ORF FT and focuses on 3 areas:

- Component 1: Harmonisation of norms and practices for the elimination of non-tariff barriers in regional trade
- Component 2: Streamlining of document and data submission requirements in regional trade
- Component 3: Simplification of customs clearance procedures; Focus: establishment of a regional Authorized Economic Operators program

The candidate is expected to fulfil tasks within the EU component as well as the BMZ-financed core business of the ORF FT.

GIZ Albania seeks the following staff: Office Manager

Overall purpose of the post.

The office manager is responsible for:

- providing administrative services for the project
- meeting the administrative needs of the programme independently, with a minimum of input and leadership
- ensuring that financial and administrative regulations are complied with
- depending on candidate qualifications at a later stage the position might be supplemented with responsibilities of junior technical assistant.

Main tasks:

1. Secretarial Work and Services

The office manager

- prepares and organizes internal meetings
- supervises adherence to deadlines
- prepares minutes, summaries and lists in agreement with the superior(s)
- coordinates logistical organization of events.

2. Administration

The office manager

- is responsible for organizing administrative and logistical aspects of programme activities (meetings, workshops etc.)
- coordinates with the GIZ office on the mode of service delivery
- ensures that computers and software function properly
- monitors the availability of accessories and stocks and carries out procurement in accordance with guidelines
- is responsible for filing documents in reference files or in DMS in line with GIZ's filing rules
- initiates and supervises local consultancy- and local subsidy contracts as well as financing contracts.

3. Finance and accounting

The office manager

- helps to prepare project budget planning and cost accounting
- helps to monitor costs and spending in accordance with the budget
- is responsible for financial management, such as cash withdrawals, keeping the cashbook, bank accounts
- checks travel expense statements of staff for approval by the superior
- supports the project management to keep track of, to supervise and document the contract provision and to account in agreement with GIZ-standing orders
- supports the programme management in the control of finance reports and files for the cost sheets of the concluded contracts
- checks and delivers the bills to pay and the remaining relevant files in the GIZ-accounting under compliance with internal rules (stamp of the project etc).

4. Other duties/additional tasks

The office manager

- PR focal point
- performs other duties and tasks at the request of management

Qualifications and experience sought

Requirements

- University degree in business administration, accounting, finance or related subjects (Master or equivalent);
- At least 3 years professional experience in a comparable position;
- Good working knowledge of ITC technologies (related software, phone, fax, email, the internet) and computer applications (e.g. MS Office);
- Albanian at native level, very good knowledge of the European language widely used in the country: English, preferably in combination with German;
- In-depth understanding of financial planning and reporting and accounting principles;
- Experience of management and administration and in organizing and conducting major events and workshops;
- Willingness to upskill as required by the tasks to be performed – corresponding measures are agreed with management.

Contract conditions:

- Part-time employment 50%
- Project office in Tirana
- Assignment period: until 31.12.2019.

Please forward your application until **24th of March 2019**, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de, including the following information: Application letter, CV in English (Euro Pass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njofton se duke filluar nga data 9 Mars 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme është si vijon:

Përshkrimi i Produktit	Çmimi prej datës 09.03.2019 (përfshirë TVSH-në)
MARLBORO PREMIUM BLACK KS BOS 20	500 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS LCB 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS BOX 10	320 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 10	320 Lekë/paketë
MARLBORO FLAVOR PLUS (FWD) KS SRP 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (4 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (6 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.0) 100 RCB 20 XSL	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.5) 100 DSP 20 SSL	280 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS BOX 20	260 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS RCB 10	260 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS SLIMSMAG 100 RCB 20 XSL	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC6M KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC4 KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
MERIT BIANCA 100 BOX 20 SSL	220 Lekë/paketë
MERIT (ORANGE) KS RCB 20	230 Lekë/paketë
L&M RED LABEL KS RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 4MG RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 6MG RCB 20	220 Lekë/paketë

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10,
1000 Tirana, Albania
Tel: +355 42 276 670



TENDER NOTIFICATION

TENDER OPPORTUNITY FOR TAXI SERVICE BUSINESS at TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport (TIA) would like to inform the interested parties about the following tender opportunity at the Terminal Building, Departure Area. The airport is a transportation hub for Albania and it represents a unique and highly attractive location for all retailers and caterers with a double digit growth in passengers.

Prospective tenants are expected to meet the following requirements:

- Experience of provision and installation of taxi services (not necessarily service for airport). Please note at least 1 year of experience is necessary.
- Taxi license of the company related to the subject of the concession (any company which fails to meet the above criteria will not be taken into consideration).
- To participate in this process interested parties will need to retrieve the Request for Proposal which can be retrieved at Tirana International Airport, Administration Building, Rinas, only on 19 March 2019 up to 15:00 Eastern Time.

Only to the companies that will submit a formal request for participation will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the proposals.

The set of tender documents will be delivered free of charge, in a CD, upon receipt of the above forms.

All inquiries and the Expression of Interest shall be addressed by hand or **to all** the following email address:

Tirana International Airport Nënë Tereza SH.PK

Administration Building
Commercial & Property Department
Rinas, Albania

Emails:

Commercial Department Alisa Gjinari agjinari@tirana-airport.com

Legal Department Ilir Alimema ialimema@tirana-airport.com

Procurement Department Albi Palushi apalushi@tirana-airport.com

"Kujdes me paratë publike", Soreca: Monitorim më të mirë për tenderat



dytë të saj dhe sipas ministres së Financave, Anila Denaj, ka në thelb transparencën dhe llogaridhënien. Kjo reforma është zbatuar për 4 vite dhe do të vijojë deri në vitin 2022 dhe ndër të tjera ka në thelb përmirësimin e shërbimeve në administratën publike dhe shpenzimet e kontrolluara.

Bashkimi Europian kërkon menaxhim më të mirë të financave publike nga të gjithë aktorët, si nga ministritë, bashkitë, institucione të pavarura si Agjencia dhe Prokurimit Publik e Kontrolli i Lartë i Shtetit e deri tek shoqatat, si kusht për anëtarësim. Ambasadori Luigi Soreca e vë theksin te monitorimi i mënyrës se si shpenzohen paratë e taksapaguesve shqiptarë. "Paratë publike janë të taksapaguesve shqiptarë dhe çdo taksapagues ka të drejtë të kërkojë

që paratë e tyre të shpenzohen siç duhet. Duhet planifikim sektorial në buxhet, sepse nëse nuk ka fonde, objektivat nuk arrihen. P.sh. nëndërtimin e rrugëve, cilësia dhe kosto kanë rëndësi dhe duhen zgjedhur tenderuesit më të mirë. Monitorimi është guri më i rëndësishëm dhe nëse kjo nuk bëhet, rruga nuk ndërtohet në kohën e duhur, e cilësinë e duhur dhe me koston më të ulët", tha Soreca. Reforma e Menaxhimit të Financave publike ka hyrë në fazën e

INSTAT: Tregtia me pakicë në rritje, ndikim kryesor nafta



Tregtia me pakicë ka regjistruar rritje në tremujorin e fundit të vitit të shkuar dhe ndikim. Instituti i Statistikave publikoi shifrat zyrtare, ku indeksi i volumit të shitjeve në tregtinë me pakicë shënon 152,5 duke u rritur 3,2%, krahasuar me të njëjtin periudhë të vitit 2017. Krahasuar me tremujorin paraardhës, ky tregues i përshtatur sezonalisht ka pësuar rënie 0,1%. Sipas INSTAT, në tregtinë me pakicë, pa përfshirë këtu tregtinë

me pakicë të hidrokarbureve, indeksi i volumit të shitjeve ka pësuar një rritje prej 2,7%, kundrejt të njëjtit tremujor të vitit të mëparshëm. Në grupin "Ushqime, pije, duhan në njësi tregtare jo të specializuara dhe të specializuara", indeksi i volumit të shitjeve, është rritur 2,4%, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017. "Indeksi i volumit të shitjeve, për grupin "Artikuj joushqimorë në njësi tregtare të specializuara dhe jo të speciali-

zuara", është rritur 2,8%, kundrejt të njëjtës periudhë të vitit paraardhës. Në grupin "Tregti hidrokarburesh në njësi tregtare të specializuara", indeksi i volumit të shitjeve është rritur 5,2%, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2017" vlerëson INSTAT.

"Transfertë në buxhetet familjare", fermerët do të marrin 495 milionë lekë në 2019

VKM, 620 milionë lekë për bujqësinë, ja kush përfiton

Rritja e sipërfaqeve të ullishtave, 125 milionë lekë subvencione

Qeveria shqiptare ka akorduar një fond prej 620 milionë lekësh për bujqësinë. Vlera do të shkojë në dy zëra 495 milionë për rritjen e konkurrenshëmërisë të produkteve bletorale e peshkimit dhe 125 milionë lekë për shtimin e sipërfaqeve të ullishtave. Në vendimin e qeverisë janë përcaktuar edhe kushtet që duhet të përmbushin fermerët për të marrë subvencione nga Ministria e Bujqësisë nga zëri "Transfertë në buxhetet familjare" dhe 125 milionë lekë nga zëri "Shpenzime kapitale me financim të huaj"



Foto ilustruese

VENDIMI

Këshilli i Ministrave miratoi dje fondin e programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, i miratuar në buxhetin e vitit 2019 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shuma prej 495 milionë lekësh, në zërin "Transfertë në buxhetet familjare", të përdoret për: rritjen e konkurrenshëmërisë së produkteve bletorale e të peshkimit dhe uljen e kostove të prodhimit, nëpërmjet pagesave të kafshëve të matrikuara, përfermat me jo më pak se 100 krerë dhe për çagë dhe sardele të peshkuara; mbështetjen e diversifikimit të aktivitetve ekonomike në zonat rurale dhe mbështetjen për Ferment Didaktike Eksperimentale, të Universitetit Bujqësor të Tiranës, për trajnimin dhe transferimin e njohurive në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural. Gjith-

ashtu, qeveria ka miratuar edhe shumën prej 125 milionë lekësh, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të huaj" për projektin "Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të ullirit", të përdoret për shtimin e sipërfaqeve të mbjella me ullinj, përmirësimin e mekanizimit dhe rritjen e kapaciteteve të prodhimit të vajit të ullirit.

MASA E SHPËRBLIMIT

Sipas vendimit, masat e mbështetjes dhe të financimit të jenë për tufën bazë të matrikulluar, përfermat me jo më pak se 100 krerë dhe/ose dhi, në vlerën 1 000 lekë/krerë. Dorëzimi qumështi lëndë e parë, në vlerën 10 lekë për litër në pikat e përpunimit, përfermat me jo më pak se 10 krerë lopë kundrejt faturës tati-more të shitjes, por jo më shumë se 700 000 lekë për subjekt. Mbarëshitim i bletarisë me 1 000 (një mijë) lekë

për zgjua përferma me jo më pak se 50 zgjoje, por masa e financimit të jetë jo më shumë se 150 000 lekë për subjekt. Ndërsa mbështetja ndaj anijeve të peshkimit me flamur shqiptar, në vlerën 20 lekë/kg për çagë dhe/ose sardele të peshkuara. Paga-të kryhet kundrejt sasive të tregtuara në stabilitmentet shqiptare vetëm për qëllime përpunimi të këtyre produkteve, të vërtetuara me fatura tati-more dhe certifikatë zënieje. Në rastin kur anijet janë në pronësi ose të marra me qira nga stabilitmentet e përpunimit të peshkut, pagesa të kryhet kundrejt sasive të verifikuara me certifikatë zënieje dhe/ose: faturave të shitjes së produkteve të përpunuara për në tregun vendës dhe të deklaruarë doganorë për eksportin e prodhimeve të përpunuara.

FINANCIMI PËR ULLISHTAT

- Mbjellje e ullinjve në vlerën 350 000 lekë/ha, për format intensive të kultivimit, dhe në vlerën 250 000 lekë/ha, për format tradicionale. Kur kultivari është autokton masa e financimit shtohet me 50 000 lekë/ha.
- Sipërfaqja e mbjellë me ullinj për fermerët individualë të jetë jo më pak se 0,2 ha, për grup fermerësh jo më pak se 1 ha, në një bllok të vetëm, për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB) jo më pak se 3 ha. Madhësia e ngastrës të jetë jo më pak se 0,2 ha, kur nuk është bllok.
- Masa e financimit për sipërfaqe të mbjellë të jetë:
 - deri në 0,5 ha, me 100% të vlerës për ha;
 - mbi 0,5-5 ha (4,5 ha e dytë) të rritet me 25% të vlerës për ha;
 - mbi 5,0 -10 ha (5 ha e tretë), të rritet me 50% të vlerës për ha.
- Masa e financimit për sipërfaqe të mbjellë, për aplikuesit me status SHBB:
 - 3-5 ha, të rritet me 40% të vlerës për ha;
 - mbi 5,0 -10 ha (5 ha e dytë), të rritet me 65% të vlerës për ha.
- Pagesa për plotësimin e numrit të bimëve në ullishtat e vjetra/degraduara në masën 70 000 lekë/ha.
- Përmirësimi i teknikave të ujtes, nëpërmjet instalimit të ujtes me pika në ullinj, jo më shumë se 250 000 lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 0,2 ha.
- Blerje e makinerive dhe e pajisjeve për vjeljen e ullirit, në 50% të vlerës totale të faturave tati-more, por jo më shumë se 5 000 000 lekë për subjekt.
- Blerje e makinerive dhe e pajisjeve për prodhimin e vajit të ullirit, në 50% të vlerës totale të faturave tati-more, por jo më shumë se 20 000 000 lekë për subjekt.
- Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural nga 6 deri në 10 dhoma, në 50% të vlerës totale të faturave tati-more, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt. Përfutjes janë subjektet, të cilat nuk mund të mbështeten nga programi IPARD II.
- Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tati-more, por jo më shumë se 10 000 000 lekë për subjekt. Përfutjes janë subjektet të cilët nuk mund të mbështeten nga programi IPARD II.

Autoriteti i Aviacionit Civil ndalon fluturimin e avionëve 'Boeing' në hapësirën shqiptare

Autoriteti i Aviacionit Civil ka vendosur të ndalojë fluturimin e avionëve 'Boeing 737-8' dhe '737-9 Max' në hapësirën ajrore shqiptare, duke iu bashkuar vendimit të Agjencisë Europiane të Sigurisë në Operim të Aviacionit (EASA). Sipas AAC-së, ky vendim ka ardhur pas aksidentit të ndodhur disa ditë më parë të avionit tip 'Boeing 737 Max 8' të shoqërisë ajrore 'Ethiopian Airlines'. Ndërkohë, Autoriteti shton më tej se ndalimi i fluturimeve do të jetë për një kohë të papërcaktuar, deri në direktivat pasuese të EASA. "AAC informon qytetarët se në Aeroportin Ndërkombëtar 'Nënë Tereza'



nuk ka në operim asnjë avion të tillë, në asnjë nga linjat e programuara të fluturimeve. Për t'ju bashkuar nisjes së EASA për këtë rast, AAC ka formalizuar lëshimin e një NOTAMi (lajmërimi për operatorët) nga ana e 'Albcontrol', i cili ndalon operimin e avionëve të

këtij lloji në hapësirën ajrore shqiptare dhe Aeroportin Ndërkombëtar 'Nënë Tereza', për një kohë të pacaktuar, deri në direktivat pasuese të EASA, të cilat do të varen nga informacioni që do të vijë nga hetimi i shkaqeve të aksidentit në Kenia", thuhet në njoftimin zyrtar të AAC-së.

"Nuk duhet ta shohim si kërcënim procesin e vettingut"

Kryeprokurorja Arta Marku: Politika ndërhyjnë te drejtësia sa herë i preken interesat

SHKODËR - Kryeprokurorja Arta Marku gjatë analizës vjetore të Prokurorisë së Shkodrës ka dhënë mesazhin e fortë që të vijnë punën të pandikuar nga politika. Ndërkohë që akuzoi këtë të fundit se jo vetëm ka "ndërhyrë në punët e organit të akuzës, por edhe se i ka dhënë të drejtën vetes të gjykojë çështjet që i takojnë prokurorisë". Gjithashtu, ajo u shpreh se prokurorët ia kanë dalë në punën e tyre, pavarësisht sfidave dhe problemeve apo dhe ndërhyrjeve

DEKLARATA

"Ky vit ishte jo i lehtë, sepse i jeni nënshtruar vettingut. Ia keni dalë, pavarësisht vështirësive. Pavarësi s'do të thotë kaos, kërkoi më shumë nga ju dhe të jeni të pavarur dhe të pandikuar në punën tuaj. Mos e shihni vettingun si ndëshkim. Keni mbështetjen time dhe të ndërkombëtareve. Ne shumë çështje politika ka ndërhyrë në punët tona, por ju keni vazhduar punën tuaj. Në qendër të debateve apo konflikteve politike ka qenë prokuroria. Politika i ka dhënë të drejtën vetes për të gjykuar çdo çështje tonën", tha kryeprokurorja Marku.

politike. Sipas Markut, viti që lamë pas ka qenë një vit i vështirë, por jo i pamundur përballë sfidave të drejtësisë. Ndërkaq, kryeprokurorja deklaroi se prokurorët nuk du-



Kryeprokurorja Arta Marku

het ta shohin si kërcënim procesin e vettingut, pasi kanë mbështetjen e saj dhe të ndërkombëtareve. "Ky vit ishte jo i lehtë, sepse i jeni nënshtruar vettingut. Ia keni dalë pavarësisht vështirësive. Pavarësi s'do të thotë kaos, kërkoi më shumë nga ju dhe të jeni të pavarur dhe të pandikuar në punën tuaj. Mos e shihni vettingun si ndëshkim. Keni mbështetjen time dhe të

ndërkombëtareve. Ne shumë çështje politika ka ndërhyrë në punët tona, por ju keni vazhduar punën tuaj. Shpeshherë jeni ndjerë të pasigurt dhe kjo padyshim që ka ndikuar në punën tuaj. Në qendër të debateve apo konflikteve politike ka qenë prokuroria. Politika i ka dhënë të drejtën vetes për të gjykuar çdo çështje tonën", tha Marku.

Vetingu zbuloi mashtrimin, Admir Thanza u shkarkua në korrik të 2018-ës

Fshehu dënimin për vjedhje në Itali, merret i pandehur ish-gjyqtari i lartë

TIRANË

Prokuroria ka dërguar në gjyq me akuzën e falsifikimit të formularit të dekriminalizimit ish-gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, Admir Thanza. Gjykata e Tiranës pranoi kërkesën e prokurorisë për të marrë si të pandehur Thanzën. Organi i akuzës së kryeqytetit mbylli hetimin për gjyqtarin në fjalë në fund të janarit. Ai akuzohet për falsifikim të formularit të dekriminalizimit. Dosja në ngarkim të tij u dërgua gjykatës, e cila dje vendosi që ish-gjyqtari të ulet në bankën e të pandehurve. Hetimi për ish-gjyqtarin Thanza nisi pas paraqitjes së tij para Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për procesin e



Ish-gjyqtari i Gjykatës së Lartë, Admir Thanza

vettingut, në të cilin rezultoi ngeles. Në këtë proces doli në dritë një gjetje e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) se Thanza rezultonte i dënuar në vitin 1999

nga Gjykata e Pizës në Itali. Dënimi me 40 ditë burg dhe 100 mijë lireta gjobë për vjedhje në një supermarketi. Vuajtja e dënimit ishte pezulluar, por asgjë nuk ishte dek-

SHKARKIMI

Ish-gjyqtari i Gjykatës së Lartë, Admir Thanza, u shkarkua nga detyra në korrik të vitit të kaluar nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, pasi nuk kishte deklaruar një dënim të marrë në Itali në 1999. Ai ishte dënuar në vendin fqinj me 40 ditë burg për vjedhje në bashkëpunim në vitin 1999. Thanza nuk e kishte deklaruar në formular këtë dënim, por për rastin, përpara anëtarëve të KPK-së tha se vjedhjen e kishte kryer kunata, por ai e mori përsipër për të ndihmuar nipin që vuanë nga një sëmundje e rëndë. Lidhur me këtë rast, prokuroria shqiptare i dërgoi një letërporosi shtetit fqinj për të mësuar detajet mbi vjedhjen që u dënua Thanza si dhe rrethanat në të cilat u krye vepra penale.

laruar rreth tij në formularët e dekriminalizimit. Një fakt i tillë u konfirmua edhe nga një letërporosi e ardhur nga shteti fqinj, në llogari të Thanzës. Admir Thanza ishte dënuar në Itali me 40 ditë burg për vjedhje në bashkëpunim në vitin 1999, kohë në të cilën ishte dhe gjyqtar në Gjykatën e Shkodrës. Përpara komisionit të vettingut, Thanza tha se nuk kishte vjedhur asnjëherë. Sipas tij, aktin e kishte kryer kunata, por e kishte marrë ai përsipër për të mos i mohuar ndihmën e saj nipit të sëmurë rëndë në

Itali. "Kam tentuar me sinqeritet maksimal që ta shpjegoj edhe në e-mail-e, edhe në materialet që kam paraqitur, ekzistencën e dënimit. Kurrë në jetën time unë nuk mund ta bëja një gjë të tillë. Mora përsipër diçka për të mbrojtur një fëmijë të mitur. Ai është gjaku im, djali i vëllait tim. Fillimisht, kurrë nuk e dija, sepse ajo ishte një marrëveshje mes avokatit dhe prokurorit dhe që më është thënë që nuk cilësohet si dënim", është shprehur Thanza para seancave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

SHKURT

Vetëvaret 38-vjeçari në burg, përfundon në koma

BERAT - Një 38-vjeçar që vuanë prej disa muajsh dënimin në IEPV-në e Beratit është gjetur i vetëvuar në qelinë e tij mesditën e djeshme. Bujar Murati nga fshati Lybeshë i rrethit të Poliçanit është gjetur në qelinë e tij nga punonjësit e burgut dhe është dërguar me urgjencë drejt Spitalit Rajonal të Beratit. 38-vjeçari ka mbërritur në spital në gjendje kome dhe për këtë arsye është dërguar me urgjencë në Tiranë. Të kontaktuar nga "News24", burimet e burgut nuk kanë dhënë asnjë informacion në lidhje me ngjarjen e rëndë, shkaqet dhe dinamikën e saj. Ajo që u arrit të mësohej nga burime konfidenciale, është fakti se Bujar Murati është xhaxhai i Ariela Muratit, studentes që u vra nga i dashuri i saj pranë fakultetit të Mjekësisë në Tiranë rreth 1 vit më parë.

Shkrumbohet gjatë natës makina, nisin hetimet

DURRËS - Një makinë është shkrumbuar mbrëmjen e së martës në qytetin e Durrësit. Burime nga policia bëjnë me dije se ngjarja ka ndodhur rreth orës 20:00 në lagjen nr.4, ku automjeti në pronësi të shtetasit Sh.B., 32 vjeç, është djegur pjesërisht në pjesën e brendshme. Ende nuk dihen rrethanat e ngjarjes, ndërkohë grupi hetimor po vijon punën për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.

Gjendet e pajetë në arë një grua 75-vjeçare

TIRANË - Një grua e moshuar është gjetur e pajetë ditën e djeshme në Lundër të Tiranës. Viktima është rreth moshës 75 vjeç, por nuk është identifikuar ende. Burime nga policia e kryeqytetit bëjnë me dije se trupi i pajetë i gruas u gjet rreth orës 09:50, në një arë. Dyshimet paraprake të autoriteteve policore janë se ajo mund të ketë ndërruar jetë për shkaqe natyrore. Kjo, pasi në trup nuk rezultoi të ketë shenja dhune apo dëmtime të tjera.

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: RFQ - "Queue Management Systems and Camera Systems" to be used in public service delivery one stop shops at the municipal level where ADISA, the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania, will be setting up its multifunctional collocated"

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP Procurement Notices 54004 - RFQ - "Queue Management Systems and Camera Systems" to be used in public service delivery one stop shops at the municipal level where ADISA, the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania, will be setting up its multifunctional collocated"**.

For more details please refer to the link below:
http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=54004

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than March 27, 2019, 14:30 p.m.

Address for communications:
 Email: procurement.al@undp.org
 Or
 Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor
 Tirana, Albania

Apeli pranon ankimin e PD-së, gjykata kërkon hetimin e deputetit Bushati për fshehje pasurie

TIRANË - Gjykata e Apelit të Tiranës ka pranuar padinë e Partisë Demokratike për deputetin socialist Ervin Bushati, të cilin e akuzon për fshehje të pasurisë. Prokuroria e Tiranës i mbyllti hetimet edhe pse Gjykata e Shkallës së Parë kishte urdhëruar që të vazhdohej procesi he-

timor ndaj Ervin Bushatit. Organi i akuzës e kundërshtoi vendimin dhe e ankoi në Gjykatën e Apelit. Kjo e fundit vendosi që të rihapet çështja dhe të vazhdojnë hetimet ndaj deputetit të Partisë Socialiste. Padia e Partisë Demokratike është bërë për herë të parë në tetor të vitit 2018, të cilin e akuzon se nuk justifikon 7 pa-

suri të paluajtshme. Vetë deputeti socialist Ervin Bushati, i ftuar në studion e "ABC News", duke komentuar padinë ndaj tij u shpreh se gjithë pasurinë e tij e ka të deklaruar sikundër ka bërë edhe vitet e tjera. Sipas deputetit socialist, padia e PD vijon pasi i është prekur interesi. (TV KLAN)

TIRANË - Pak ditë pas vendimit të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda që shpëtoi nga burgu përjetë Dritan Dajtin, një tjetër hap është hedhur nga akuzat. Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda iu drejtua me rekurs Gjykatës së Lartë, të cilës i kërkoi prishjen e vendimit të Apelit dhe rikthimin e dënimit me burgim të përjetshëm për Dritan Dajtin, i cili akuzohet për vrasjen e 4 oficerëve të policisë në

Ulja e dënimit për Dritan Dajtin, prokuroria rekurs në Gjykatën e Lartë: Të priset vendimi

vitin 2009 në Durrës. Dajti pas një kalvari 10-vjeçar përballjeje me drejtësinë, përfundimisht u dënua me 25 vite burgim për shkak se Apeli i Krimeve të Rënda pranoi kërkesën për gjykim të shkurtuar. Pas vendimit që u konsiderua skandal, prokuroria nisi hetimet për 3 nga 5 gjyqtarët e çështjes "Dajti", me vendim gjykat

u ushtrua kontroll në banesat e gjyqtarëve Skënder Damini, Petrit Aliaj dhe Aleks Nikolli. Në banesën e Daminit u gjetën 17 mijë euro dhe disa fishekë. Lidhur me paratë, gjyqtari pretendon se i përkasin të birit dhe i është drejtuar gjykatës me kërkesën për rikthimin e tyre. Njëherazi prokuroria ka sekuestruar

telefonat celularë të 3 gjyqtarëve dhe i ka dërguar ato për ekspertizë, me qëllim zbulimin e kontakteve që mund të kenë pasur ata me persona të njohur me Dajtin që mund të kenë ndikuar. Në kuadër të hetimit, prokuroria ka sekuestruar edhe librat e hyrje-daljeve në paraburgim, duke listuar emrat e personave që janë



Dritan Dajti në sallën e gjyqit

takuar me Dritan Dajtin, të cilët pritet të merren në pyetje. Pas kalvarit në gjatë të përballjes me drejtësinë, Dajti ia doli të hiqte nga su-

pet burgimin e përjetshëm dhe përfundimisht u dënua me 25 vite burgim, për atë që u konsiderua si masakra e Durrësit.

Ngjarja e 27 majit 2015, si u ekzekutuan Besnik Sulku, Mentor Lufi dhe Gert Goxhaj

Masakra me 3 të vranë të "Zogu i Parë", Apeli: Burg të përjetshëm për vrasësin italian

Vendimi, 47 vite burg në total për 2 vëllezërit Doçi

TIRANË
Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka lënë dje në fuqi dënimet e dhëna nga Shkalla e Parë për tre autorët e masakrës së ndodhur afro katër vite më parë në bulevardin "Zogu i Parë", ku mbetën të vranë tre persona. Apeli vendosi dënimin me burgim të përjetshëm për italianin Salvatore Letizia, 27 vite për Markeljan Doçin dhe 20 vite për vëllain e tij, Klevis Doçin, të akuzuar për ngjarjen e ndodhur më 27 maj të vitit 2015 në bulevardin "Zogu I", ku mbetën të vranë shtetasit: Mentor Lufi (Doçi), Gerti Goxhaj dhe Besnik Sulku. Dyshohet se ngjarja e ndodhur në Tiranë është një zinxhir hakmarrjesh që lidhet me vrasjen e Durim Sulkut në Holandë në prill të vitit 2015.

DOSJA E PROKURORISË

Nga hetimet e Prokurorisë për Krime të Rënda është arritur në përfundimin se ngjarja e ndodhur në muajin maj 2015 në Tiranë është vijim i një konfliktit të nisur më parë po në kryeqytet, në dhjetor 2014 dhe që ka vazhduar në Holandë, në prill 2015 e më tej është shoqëruar me ngjarjen për të cilën akuzohen tre të pandehurit. Në bazë të veprimeve hetimore, Prokuroria për Krime të Rënda i paraqet gjykatës dinamikën e ngjarjes, e cila është rindërtuar në bashkëpunim edhe me autoritetet holandeze. Në dhjetor 2014, shtetasi Mentor Lufi (Doçi) plagoset me armë zjarri në zonën e ish-stadiumit "Dinamo", në Tiranë dhe autorët largohen. Shënjestra e atentatit, Lufi, ka dyshuar se sulmi ndaj tij është organizuar nga vëllezërit Durim dhe Besnik Sulku. Ndërmjet Mentor Lufit dhe vëllezërve Sulku kishte nisur një konflikt në Holandë, ku ata udhëtonin dhe qëndronin shpesh. Pas atentatit me pasojë plagosjen, Lufi organizoi nipat e tij, Markeljan dhe Klevis Doçi, për t'u hakmarrë. Në prill 2015, dy vëllezërit Doçi i bëjnë atentat me armë Durim Sulkut në qytetin Ridderkerk të Holandës. Nga veprimet hetimore të autoriteteve



Vrasësi italian, Salvatore Letizia



Vendi ku ndodhi masakra

VENDIMI I APELIT PËR KRIME TË RËNDA

1. Salvatore Letizzia, burgim të përjetshëm
2. Markeljan Doçi, 27 vite burg
3. Klevis Doçi, 20 vite burg

holandeze rezultoi se Durim Sulku gjendej në një automjet tip "Smart", kur është qëlluar për vdekje disa herë me pistoletë nga Markeljan Doçi, i cili ishte i shoqëruar nga vëllai i tij, Klevis Doçi, gjithashtu i armatosur. Pas atentatit në Holandë, vëllezërit Doçi rikthehen në Shqipëri, duke iu shmangur autoriteteve holandeze. Pas thuasje dy muajsh nga vrasja në Holandë, konkretisht pasditën e datës 27 maj 2015, Mentor Lufi, dy nipat e tij Markeljan e Klevis Doçi, si edhe miku i tyre, Gerti Goxhaj gjendeshin në një lokal pranë Fakultetit të Shkençave, në bulevardin "Zogu i Parë", në Tiranë. Pasi janë ngritur nga lokali, ata kanë hipur në dy mjete dhe

konkretisht: Mentor Lufi ishte pasagjer në mjetin e drejtuar nga Gerti Goxhaj, ndërsa vëllezërit Markeljan dhe Klevis Doçi gjendeshin në një automjet pas të parit, ku në timon ishte Markeljan. Sapo kanë hipur në automjete, në dy pjesët anësore të makinës së parë janë afruar dy persona të armatosur, të cilët kanë qëlluar personat që gjendeshin në bordin e saj, konkretisht Mentor Lu-

fin (Doçi) dhe Gert Goxhaj. Nga goditjet me armë ka vdekur në vend Goxhaj dhe është plagosur rëndë Lufi, i cili vdiq pak çaste më vonë. Në momentin e goditjes me armë, Markeljan Doçi afrohet me sheqerësi makinën drejt aten-

tatorëve, duke përplasur fillimisht njërin prej tyre. Ky i fundit, i cili më pas rezultoi se ishte Besnik Sulku, ka qëlluar me pistoletë në drejtim të mjedit të dytë, por pa u shkakuar dëme tek vëllezërit Markeljan dhe Klevis Doçi. Të gjendur nën goditjen e armës tip pistoletë nga ana e Besnik Sulkut, Markeljan, gjithashtu i armatosur me pistoletë, ka reaguuar duke qëlluar me armë. Markeljan dhe Sulku kanë vijuar të qëllojnë njëri-tjetrin, derisa Besnik Sulku ka mbetur i vdekur, pak metra larg

nga automjetet.

Menjëherë pas ngjarjes, forcat e policisë organizuan operacionin për arrestimin e personave të përfshirë. Fillimisht në vendngjarje u arrestuan vëllezërit Markeljan dhe Klevis Doçi. Më vonë, pranë një hoteli në atë zonë, u arrestua edhe shtetasi italian, Salvatore Letizia, i cili rezultoi se është personi që së bashku me Besnik Sulkun, ishte pjesë e vrasjes së shtetasit Mentor Lufi dhe Gerti Goxhaj. Në përfundim të hetimeve, bazuar në këqyrtjen e vendit të ngjarjes, provave shkencore dhe bashkëpunimit me autoritetet holandeze, Prokuroria për Krime të Rënda ka ngritur akuzat, si vijon:

1. Markeljan Doçi, lindur më 1981, në Bulqizë, akuzohet për kryerjen e veprave penale të: "Vrasjes me paramendim", kryer në bashkëpunim, në dëm të viktimës Durim Sulku (për ngjarjen në Holandë), "Vrasje e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme", në dëm të viktimës Besnik Sulku, "Mbajtje pa leje të Armëve Luftarake", dy herë.
2. Klevis Doçi, lindur më 1993, në Bulqizë, akuzohet për kryerjen e veprave penale të: "Vrasjes me paramendim", kryer në bashkëpunim, në dëm të viktimës Durim Sulku (për ngjarjen në Holandë) dhe "Mbajtje pa leje të armëve luftarake".
3. Salvatore Letizia, lindur më 1981, lindur Czertza (Itali), akuzohet për kryerjen e veprave penale të: "Vrasjes me Paramendim", kryer në bashkëpunim, në dëm të viktimës Gerti Goxhaj, "Vrasje për Gjakmarrje", kryer në bashkëpunim, në dëm të viktimës Mentor Lufi (Doçi) dhe "Mbajtje pa leje të Armëve Luftarake".

SHPLLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbanues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruvova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 08.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i III-të për shpëtim dhe pasurisë së pallogjishme. Apartament me sipërfaqe totale 45.3m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurisë 5628+1-26, Vol.13, Fq.41, Zk-3976 në pronësi të Hipotekuesit shqop, Sina Konstruksion 2008 sh.p.k me adresë Skoczi, Tiranë me vlerë fletëstare në ankand 9,132.48 (Nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e dy pikë dyzet e tetë) EURO dhe Apartament me sipërfaqe totale 63.3m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurisë 5628+1-26, Vol.13, Fq.42, Zk-3976 në pronësi të Hipotekuesit shqop, Sina Konstruksion 2008 sh.p.k me adresë Skoczi, Tiranë me vlerë fletëstare në ankand 12,761.28 (Dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë njëzet e tetë) Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888, email enuar.merko@gmail.com

PENSIONET E PLEQËRISË

INTERVISTA

Drejtoresha e patronatit INAS: Vitet e punës me sigurime, dokumentacioni

Ekspertja: Si të bëni verifikimin e kontributeve për të marrë pensionin

"Formulari "Periudha Sigurimi", të dhënat që nevojiten"

Voltiza Duro

Të moshuarit që kanë mbushur moshën dhe vitet e punës me sigurime, mund të paraqiten pranë patronatit INAS Albania, për të verifikuar kontributet që kanë arritur të sigurojnë. Kështu, aplikantët do të jenë më të qartë mbi masën e pensionit që do tu takojë në bazë të ligjit për sigurimet shoqërore. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Beskida Aliaj, drejtuese e këtij patronati bën me dije se falë bashkëpunimit me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, kanë akses të verifikojnë në arkivën e këtij institucioni, të gjitha periudhat e punës dhe kontributeve të derdhura. Ajo më tej sqaron për të moshuarit edhe kushtet që duhet të përmbushin si dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë për të përfituar këtë masë pagese. Aliaj thekson se verifikimi i periudhave kontributive kryhet nga ky patronat edhe për shqiptarët që kanë punuar e jetuar në Itali.

Nëse i moshuari që ka mbushur moshën e daljes në pension, nuk ka informacion të saktë mbi periudhat e punës me kontribute, si duhet të veprojë për të kryer verifikimet e duhura?

Sa i përket shqetësimit për mungesën e librezës së punës, në këtë aspekt një ndihmë të rëndësishme e ofron patronati INAS. Çdokush mund t'i drejtohet patronatit për të pasur konfirmim për periudhat e punës e të kontributeve të derdhura në të gjithë institucionet dhe ndërmarrjet ku ka punuar. Bazuar në marrëveshjen që INAS ka lidhur me Institutin e Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri, ISSH, patronati është në gjendje të verifikojë të gjitha periudhat kontributive, në arkivin e këtij institucioni.

Si veprohet kur i moshuari që do të aplikojë për pension, ka informacion të saktë mbi periudhat



Drejtoresha e patronatit INAS, Beskida Aliaj

DOKUMENTACIONI:

- ▶ Fotokopje e kartës së identitetit
- ▶ Certifikatë e gjendjes familjare
- ▶ Certifikatë martesë për gratë (për efekt të mbiemrit të kohës së vajzërisë, me të cilin mund të ketë periudha pune)
- ▶ Dy fotografi
- ▶ Libreza e punës (në mungesë të saj plotësimi i rubrikave të punës);
- ▶ Vërtetimi i Degës Ushtarake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për kërkuesit meshku)
- ▶ Diploma e shkollës së lartë për gratë (e cila konsiderohet vjetërsi pune)
- ▶ Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton qenien në punë;
- ▶ Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit tip (nëse ka punuar dhe ka derdhur kontribute për periudhat pas datës 01.01.1994)
- ▶ Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton pagën ose derdhjen e periudhave kontributive
- ▶ Fotokopje e Librezës së pagimit të energjisë elektrike

e kontributeve?

Në rast të kundërt - pra, kur i interesuari i di me saktësi periudhat e punës e të kontributeve të derdhura, në çastin e aplikimit për pension, përpilon formularin PERIUDHA SIGURIMI.

Çfarë të dhënash duhet të plotësohen në këtë formular?

Në formularin 'Periudha Sigurimi', kandidati që do të aplikojë për pension duhet të shënojë në rend kronologjik, të gjitha të dhënat mbi periudhat kontributive. Këto të dhëna përfshijnë:

ndërmarrjen, institucionin, ish-kooperativën apo subjektin ku ka punuar individvi. Gjithashtu, duhet të specifikojë detyrën që ka kryer, datën e fillimit dhe të largimit nga ai vend pune si dhe vërejtjet.

Duhet të jetë domosdoshmërisht vetë i interesuari gjatë aplikimit?

Për aplikimin për pension, sipas mundësisë që kandidatët kanë, ose mund të paraqiten vetë, ose të prokurorjve një të afërmin e tyre. Të gjitha procedurat mund t'i kryejë edhe me ndi-

hmën e drejtpërdrejtë të INAS-it, pa asnjë pagesë.

Cilat janë kushtet e përfitimit të pensionit të pjesshëm të pleqërisë?

Personat që kanë periudha sigurimi, kanë të drejtën e përfitimit të pensionit të pjesshëm të pleqërisë kur: plotësojnë moshën 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç e 10 muaj plus me koeficientin e rritjes së jetëgjatësisë për gratë; kanë jo më pak se 15 vjet periudha sigurimi dhe jo më shumë se 35 vjet periudha sigurimi; janë tërhequr nga veprimtaria ekonomike.

A mund të na jepni një shembull në lidhje me këtë?

Nëse një person ka punuar 21 vite me kontribute në Shqipëri e mbush moshën 60 vjeç e 6 muaj, atëherë do të përfitojë pension të pjesshëm pleqërie, që është i barabartë në përçindje me raportin 21 vite që ka punuar, me 35 vite që nevojiten për pension të plotë pleqërie, pra përfituesi do të marrë 60% të pensionit të plotë.

Cili është dokumentacioni që nevojitet?

Dokumentacioni që duhet të paraqisni janë: fotokopje e kartës së identitetit, certifikatë e gjendjes familjare; certifikatë martesë për gratë (për efekt të mbiemrit të kohës së vajzërisë, me të cilin mund të ketë periudha pune); dy fotografi; libreza e punës e në mungesë të saj plotësimi i rubrikave të punës; vërtetimi i Degës Ushtarake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për kërkuesit meshku); diploma e shkollës së lartë për gratë e cila konsiderohet vjetërsi pune. Gjithashtu aplikuesit i nevojitet çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton qenien në punë; vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit tip nëse ka punuar dhe ka derdhur kontribute për periudhat pas datës 01.01.1994. Ndërkaj, aplikuesi duhet të dorëzojë edhe çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton



KUSHTET E PËRFITIMIT:

- ▶ Plotësojnë moshën 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç e 10 muaj plus me koeficientin e rritjes së jetëgjatësisë për gratë;
- ▶ Të kenë jo më pak se 15 vjet periudha sigurimi dhe jo më shumë se 35 vjet periudha sigurimi;
- ▶ Të jenë tërhequr nga veprimtaria ekonomike

pagën ose derdhjen e periudhave kontributive si dhe një fotokopje të librezës së pagimit të energjisë elektrike.

Si bëhet verifikimi i periudhave kontributive në Itali?

Patronati është në gjendje të verifikojë të gjitha periudhat kontributive, në arkivin e institucionit Istituto Nazionale Previdenza Sociale e thënë ndryshe INPS ose institucion ky analog me Institutin e Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri.

Sa zgjatën procedurat e verifikimit për ata shqiptarë që kanë punuar me kontribute në shtetin italian?

Duke qenë se në Itali ky shërbim ofrohet i informatizuar, në mund të futemi online në sistemin INPS meqë kemi akses dhe passwordet e ofruara nga vetë institucioni dhe i nxjerrim këto periudha të punës në Itali, për qytetarin shqiptar, për jo më shumë se 5 minuta dhe mjafton që qytetari të ketë me vete një kartë identiteti dhe një codice fiscale.

Çfarë është ekstrati i periudhave kontributive në

Itali?

Ektrati i periudhave kontributive është dokumenti që rendit të gjitha kontributet e bëra në INPS në favor të punëtorit. Ai përmbledh pagesat e punës, figurativet dhe reduktueset, të ndara sipas ndërmarrjeve ku punonjësit është i regjistruar. Me ekstratin e periudhave kontributive punonjësit mund të kontrollojnë rregullsinë e kontributeve të paguara nga ata vetë ose punëdhënësit e tyre për sinjalizuar edhe donjëz disakordancë me INPS.

Si bëhet ndarja e sigurimeve shoqërore në shtetin fqinj për shqiptarët?

Deklarata e Pensionit detajon të dhënat personale të punonjësit dhe, përmbledhur në një tabelë, përfitimet e sigurimeve shoqërore të ndara në: periudhën e referencës; llojin e kontributeve pra të punësuar; zëjtar; tregti, shërbim ushtarak; shpërbim ose të ardhura, referencat e punëdhënësit si dhe kontributet të dobishme të shprehura në ditë, javë ose muaj, si për llogaritjen e pensionit ashtu edhe për arritjen e të drejtës.



"Baza e vlerësuar. Ja shembujt konkretë bazuar në formulën e llogaritjes"

Beskida Aliaj: Si të llogarisni saktë pensionet e pleqërisë

Tabela me pagat e indeksuara nga viti 1994 deri në 2019-ën

Voltiza Duro

Për llogaritjen e pensionit të pleqërisë si pas ligjit 104/2014, neni 18, i cili ndryshon nenin 32 të ligjit 7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" përcaktohet si më poshtë: Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. Ndërkohë shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit që ka realizuar personi me periudhën e sigurimit të kërkuar sipas nenit 92, shumëzuar me pensionin social. "Ndërsa shtesa do të jetë 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, e llogaritur sipas nenit 31 të ligjit 104/2014 (i cili ndryshon nenin 59 të ligjit 7703 datë 11.05.1993). Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social". -thekson Aliaj për "GSH". Kjo e fundit bën me dije për të gjithë të interesuarit se për ta pasur sa më të qartë këtë përlogaritje, është e nevojshme të dihet se çfarë përfaqëson pensioni social. Ndërkohë, sipas ligjit 104/2014, pensioni social është një përfitim që i jepet çdo shtetasi shqiptar, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç, është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri të paktën për pesë vitet e fundit, nuk plotëson kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka të ardhura, ose të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër, janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social. Masa e këtij pensioni social është e barabartë me të ardhurat minimale që sigurohen nga pensioni i pjesshëm i pleqërisë me 15 vite të siguruar me pagë minimale, i llogaritur në datën 31.12.2014. Ndërsa masa e pensionit social për personat që kanë të ardhura nga burime të tjera, do të jetë sa diferenca e pensionit social me të ardhurat e tjera që ka përfituesi. Për llogaritjen e pensionit përdoret formula: PP (Pensioni i pleqërisë) = PS (Pension Social)



sionit. Po të marrim një rast konkret; në vitin 2008, paga minimale ka qenë 14 830 lekë, duke u shumëzuar me koeficientin e indeksimit (i cili miratohet çdo vit me VKM), që është 1,48 jep pagën minimale prej 22.000 lekë. Po kështu dhe paga maksimale e cila ka qenë 74.150, kur shumëzohet me po këtë koeficient indeksimi jep pagën maksimale aktuale 97.030. Sigurisht pagat e ndërmjetme, me indeksimin sipas koeficientëve përkatës, do të na japin paga aktuale ndërmjet minimale e maksimales", -thekson drejtoresha e patronatit INAS Albania. Kjo e fundit konkretizon më tej duke treguar se në rast se marrim në mënyrë hipotetike që një punonjës para vitit 1994 ka një vjetërsi kontributive prej 15 vitesh dhe paga mesatare e indeksuar rezulton në një shumë prej 25 000 lekë dhe mbas vitit 1994 ka një vjetërsi kontributive prej 22 vite me një pagë mesatare të indeksuar prej 30 000 lekësh, atëherë baza e vlerësuar do të llogaritet:

(shumëzuar) vjetërsi kontributive të realizuara/vjetërsi kontributive që kërkohet +1/100 (shumëzuar) vite sigurimi* (shumëzuar)BV (baza e vlerësuar)

BAZA E VLERËSUAR

Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. "Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data 1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit. Për periudhën e sigurimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore para datës 1.1.1994, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Për periudhën e sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese të caktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave", -bën me dije Aliaj. Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit si ish-punonjës i institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore përpara vitit

1994 si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomikisht aktiv pas datës 01.01.1994. Ekspertja thekson se për efekt të llogaritjes së pensioneve me datë fillimi pas 1.1.2016 e në vazhdim, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat referuese sipas llojit të punës ose funksionit përpara datës 01.01.1994 si edhe mbi pagat individuale mbi të cilat janë paguar kontributet sipas viteve, nga 01.01.1994 deri në 31.12.2015, të indeksuara me indeksin që del nga pjesëtimi i pagës minimale në shkallë vendi të vitit 2015 me pagën minimale të vitit 1994 ose me pagën minimale të vitit përkatës. Koeficientët e indeksimit sipas viteve përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Koeficienti i indeksimit para vitit 1994, aktualisht është 8,59.

SHEMBUJ KONKRETË

"Për ta konkretizuar këtë problem po të marrim një pagë referuese për një specialist të lartë në ndërmarrje ekonomike, që aktualisht është e miratuar në masën 4.192 lekë, duke e shumëzuar me koeficientin 8,59, e indeksuar deri në periudhën aktuale jep një pagë prej 36.009 lekë. Ndërsa mbas vitit 1994, merren pagat respektive sipas viteve, të cilat duke u shumëzuar me koeficientët përkatës, japin pagën për efekt të llogaritjes së pen-

Baza e vlerësuar = (15*25.000 lekë + 22 * 30.000 lekë) : 37 (vite gjithsej) = 28.000 lekë. Pensioni mujor = (6.750 *37/35,7) + (1/100 *37*28.000) = 6.996 + 10.360 = 17.356 lekë. Sipas nenit 33 të ligjit 104/2014, i siguruari, i cili ka plotësuar kushtet për pension pleqërie sipas nenit 43 të këtij ligji, merr shtesë në masën 0,5 për qind të pensionit për çdo muaj që sh-tyn datën e daljes në pension dhe vazhdon të paguajë kontribute. Përfituesi i pensionit të pleqërisë, që ndërpret pensionin, vazhdon të punojë dhe paguan kontribute, merr shtesë mbi pension në masën 0,5 për qind për çdo muaj ndërprerjeje. Kjo shtesë llogaritet mbi atë masë pensioni që rezulton pas rritjeve dhe indeksimit që ka pësuar pensioni gjatë kohës së ndërprerjes. "Në rastin e mësipërm, në qoftë se, ky person ka punuar mbi moshë për një periudhë prej 1 viti e 6 muaj, shtesa mbi pension do të llogaritet, 18 muaj * 0,5 = 9% * 17.356 = 1.562 lekë. Në këto kushte pensioni që do të përfitonte aplikuesi do të ishte i barabartë me shumën: 17.356 + 1.562 = 18.918 lekë", -thotë Aliaj.

KOEFICIENTËT E INDEKSIMIT TË PAGAVE

Për pagat referuese deri më 1.1.1994	8.76;
◆Për pagat e vitit 1994	8.76;
◆Për pagat e vitit 1995	7.05;
◆Për pagat e vitit 1996	5.47;
◆Për pagat e vitit 1997	5.47;
◆Për pagat e vitit 1998	4.57;
◆Për pagat e vitit 1999	3.71;
◆Për pagat e vitit 2000	3.38;
◆Për pagat e vitit 2001	2.89;
◆Për pagat e vitit 2002	2.67;
◆Për pagat e vitit 2003	2.39;
◆Për pagat e vitit 2004	2.17;
◆Për pagat e vitit 2005	1.97;
◆Për pagat e vitit 2006	1.79;
◆Për pagat e vitit 2007	1.71;
◆Për pagat e vitit 2008	1.51;
◆Për pagat e vitit 2009	1.39;
◆Për pagat e vitit 2010	1.33;
◆Për pagat e vitit 2011	1.28;
◆Për pagat e vitit 2012	1.23;
◆Për pagat e vitit 2013	1.18;
◆Për pagat e vitit 2014	1.18;
◆Për pagat e vitit 2015	1.02;
◆Për pagat e vitit 2016	1.02;
◆Për pagat e vitit 2017	1.00;
◆Për pagat e vitit 2018	1.00;
◆Për pagat e vitit 2019	1.00.

Grëfhet inxhinierja: Eksperienca në Greqi, e veçanta e projektit ku mora pjesë

Klea Sanka:

Gjermania më hapi dyert e suksesit, ja si shkëlqejnë shqiptarët në botë

"E vetmja gjë që do më kthente në Shqipëri është familja"

Egla Xhemali

Një rrugëtim i shoqëruar nga puna dhe sukcesi i një jete dedikuar dijes. Njeriu në çdo fazë të procesit të evolucionit të tij nuk ndihet asnjëherë i plotësuar. Ai ka nevojë që gjithmonë të jetë në kontakt me gjërat e reja dhe kur kthen kohën pas shpreh gjurmët që ka lënë nëpër udhën e gjatë. Nuk ka më bukur kur gjithë munda vlerësohet. Klea Sanka është rasti i vajzës që ndërtoi ëndrra për të studiuar përtej kufijve. U pikas si studente ekselente e degës "Inxhinieri-informatike" dhe kështu në vitin e fundit të bachelorit fitoi një bursë studimi nga DAAD. "Qendra gjermane për shkëmbimin e studentëve nëpër botë" i hapi dyert për të nisur një kapitull tjetër në "vendin e ëndrrave". Inxhinierja duke ruajtur modestinë ndaj gjërave që ka arritur vjen në një rrëfim për "Gazeta Shqiptare" për të na shuar kureshtjen e vështirësive që ka hasur në Gjermani, vlerësimin që u bëhet studentëve shqiptarë në botë, eksperiencën në konferencën e uebit në Greqi, pasionet që e thërresin së brendshmi, fëmijërinë dhe arsyen që do e kthente në Shqipëri. Një formim i përgjithshëm për t'u admiruar ndikuar nga leximet e shumta, shije e hollë për muzikën e mirë, vizatimet dhe një mendje inteligjente që shkon përtej punës si inxhinieri. Sanka aktualisht është e punësuar si data science në një nga kompanitë më të mëdha në Gjermani e quajtur "Trivago", ku ka fatin të punojë me 53 shtetas të tjerë në një ambient të ngrohtë. Me gjithë këto të mira që i ka arritur përtej këmbënguljes, punës së palodhur dhe pasionit duket se Klea Sanka është e përkëdhelura e Zotit.

Ke studiuar në Gjermani, cila ka qenë vështirësia e parë kur nisi jetën atje?

Nëse ti pyet këdo person që ka lëvizur jashtë shtetit, padiskutim që do të thotë se ka shumë probleme me procedurat, me burokracinë pasi



nuk je në vendin tënd. Ka shumë gjëra që duhet të rregullosh; leja e qëndrimit, të regjistrohesh nëpër qytete, hapja e llogarive bankare etj. Kur je pa përvojë dhe aq i ri sa kam qenë unë të duket sikur "të mbysin", sikur nuk e sheh dot fundin megjithatë do guxoja do thosha se ky ka qenë një problem vetëm për muajt e parë. Problemi më i madh vazhdoi të jem e mendimit që është diferenca sociale dhe ajo kulturore. Kam qenë gjithmonë e mendimit (duke pasur një pjesë të jetës në Itali) kam thënë vend i Evropës Perëndimore dhe isha e mendimit se Gjermania nuk ishte dhe aq ndryshe. Ajo që më habiti më shumë është se ndryshimi dhe diferenca sociale është shumë e madhe e në qoftë se nuk je i përgatitur mund ta humbasësh fare. Ka shumë gjëra, që unë i merrja të mirëqena në mënyrën se si flisja me njerëzit, në mënyrën e trajtimit të tyre, se si krijoi shoqëri dhe çfarë prisja nga ata. Të them të drejtën është shumë e vështirë kur vjen si i huaj dhe sidomos kur niveli i gjuhës gjermane nuk është në atë rrethshmerinë që do të doje duke qenë edhe se studimet i kam në anglisht. Është vështirë të krijosh shoqëri, sidomos me vendasit dhe kur kam arritur të krijoj shoqëri të tilla e pyesja shpesh veten për shumë gjëra. Për shembull mendoja a organizoheshin grupe studimi si në Tiranë,

pasi të tillë përvojë kisha pasur, me personat që ti studion që kalon kohën që duhet të përgatitesh për një provim të krijon shoqëri. Ne me të vërtetë jemi një popull i ngrohtë, jemi dashamirës, jo se gjermanët nuk janë megjithatë një mund të presësh që të krijosh shoqëri pasi janë me të mbyllur.

Çfarë i bën studentët shqiptarë të vlerësohen shumë nëpër botë?

Ideja që ka shumë studentë që janë larguar nga Shqipëria është e saktë, sepse kam shumë bashkëmohatarë, me të cilët kam studiuar që tani kanë lëvizur në vende të Europës. Mendoj se kemi disa avantazhe dhe disa disavantazhe me studentët e tjerë; për shembull në krahasim me studentët që vijnë nga vendet aziatike ka të bëjë me faktin se ata janë edhe më larg Europës se sa ne. Kjo në një farë mënyre e bën më të vështirë pjesën e përshtatjes për ta. Kina ka një lloj qeverie komuniste që nuk lejon parti tjetër që të vijë në pushtet. Është një vend me popullsi shumë të madhe e me kushte të tjera socio-ekonomike. India po ashtu. Kanë një lloj besimi fetar komplet tjetër, mënyra se si jeta jetohet është krejt tjetër domethënë në krahasim me këto vende ne shqiptarët e kemi më të lehtë. Nga ana tjetër nuk do thosha që ne jemi studentët apo populli më punëtor. Jemi shumë punëtor,

po jo më punëtorët. Ndoshta nuk ka popull më punëtor apo student më punëtor. Fakti që për ne është shumë herë më e vështirë se sa për një vendas gjerman apo një student tjetër, që vjen nga një vend tjetër i BE na bën ne që të jemi edhe pak më të përgjegjshëm në mënyrën se si studiojmë. Kam njohur shumë persona dhe në përgjithësi shqiptarët janë më të vetëdijshëm për atë që po bëjnë. Ne nuk kemi avantazhin e të pasurit një leje qëndrimi, në cilindo vend të Europës duke mos qenë pjesë e BE dhe kjo na bën ne që të duam t'i mbyllim studimet sa më shpejt. Kam vënë re që gjermanët e merrnin shumë lehtë e lehtë shkollën. Zgjidhnin një apo dy lëndë në semestër, mësonin vetëm për ato dy lëndë e zakonisht kishin rezultate shumë të mira për ato dy apo tri lëndë, kurse ne që vinim nga vendet e tjera, që duhet t'i mbyllim studimet në kohë ishim më seriozë duke punuar më fort për të dalë me rezultate shumë të mira në pesë apo gjashtë lëndë. Ne kemi një lloj ndjenje detyrimi dhe përgjegjësie më të lartë se sa të tjerët dhe kjo mendoj unë që na jep një lloj avantazhi jo vetëm në studime, po dhe në mënyrën se si e përballojmë jetën. Jemi më të pjekur se sa moshatarët tanë të vendeve të BE që studiojnë këtu.

Eksperienca në Greqi. Çfarë të tërhoqi më shumë vëmendjen?

Në Greqi shkova për një konferencë që kishte të bënte me zhvillimet në ueb. Vendosi që të shkonim me një grup kolegësh nga puna. Konferenca kishte disa aktivitetet që zgjasnin një javë të tërë domethënë mbledhje në darkë, që njihen paneli i personave që do flisnin (persona me profil të lartë që vinin nga kompani të mëdha, për shembull Amazon), kishte përfaqësues natyrisht dhe nga vende të tjera të Europës dhe kompania jonë "Trivago" mbulonte një pjesë dhe sponsoroonte një pjesë të shpenzimeve të kësaj konferencie. Gjithsesi shkuam në kohë për aktivitetet e dy netëve. Patëm një mikpritje shumë të ngrohtë nga persona, të cilat

organizonin konferencën duke qenë se një nga koleget e mia ishte dhe organizatore e një workshop-i që do mbahej. Kemi pasur një sërë aktivitetesh. Pjesa e workshop-it zhvillohej në një universitet në Selanik dhe folësit kishin organizuar projekte, që do na mësonin se si ti bënim hap pas hap. Projekti që zgjodha të merrja pjesë ishte pak i ngadaltë si ritëm. Ishin gjëra që unë i kisha parë, por për dikë me zero eksperiencë ishte shumë i dobishëm. Dita tjetër ishte dita e fjalimeve të mëdha. U organizua te teatri i Selanikut. Qe një eveniment me shumë njerëz dhe pati folës nga kompani të ndryshme që pak a shumë shpjegonin teknologjitë, që qëndronin pas kompanive të tyre, çfarë promovonin se si i shikonin ata kulturën e fushës në të cilën ne punojmë. Ishte diçka mjaft interesante.

Sa e vështirë është ta ushtrosh profesionin në një vend të huaj?

Varet nga profesioni. Unë kam fatin e mirë që profesioni në të cilin punoj fillimisht si inxhinieri softi, pastaj më vonë me temën e masterit si "Data Science" është një profesion ndërkombëtar dhe materialet, në të cilat studiojmë dhe natyra e marrëdhënieve që kemi dhe asaj çfarë bëjmë ka një frymë ndërkombëtare. Një pjesë shumë e madhe e kompanive kërkojnë që jeta e përditshme në punë dhe çdo gjë të bëhet anglisht që është gjuha zyrtare e shumë kompanive siç është gjuha e kompanisë, në të cilën unë punoj për momentin. Në këtë aspekt nuk është aq problematike. Sa i përket burokracive të fillosh një punë në një mënyrë apo në një tjetër është e vështirë nëse nuk vjen nga një vend i BE, pasi ke shumë disavantazhe megjithatë ka gjithmonë e më shumë kompani që ndihmojnë me leje qëndrimi, me kurse gjermanishtje. Nëse ti fiton vendin e punës të ndihmojnë të kesh një hyrje shumë të lehtë në jetën gjermane. Mjedisi ku unë punoj aktualisht është ndërkombëtarë. Ka shumë persona nga rreth 53 shtete të ndryshme të botës. Sigurisht, shumica janë gjermanë është

e pritshme, por ka një lloj larmishmërie personash e nacionalitetesh që me të vërtetë nuk e ndjen veten shumë i huaj siç mund ta ndjesh në vende të tjera. Atje është në një farë mënyre një mjedis shumë mikpritës dhe i ngrohtë për të gjithë e në këtë lloj aspekti kam qenë me fat.

Cilat janë pasionet që të thërresin së brendshmi?

Më pëlqejnë shumë gjëra. Cuditërisht më pëlqejnë pasionet që kam pasur në gjimnaz, si matematika që vazhdoi ta aplikoj edhe në punën e përditshme, më pëlqen ajo që mësoi në punën e përditshme, mënyra se si duhet të studioj përdoruesit dhe se si ti lidh këto lloj sjelljesh në një funksion matematik dhe të jem gjendje pastaj që të parashikoj sjelljet e tyre në planformat online. Është me të vërtetë një projekt shumë intrigues megjithatë ka edhe gjëra të tjera, që më apasionojnë shumë, ndër të cilat historia e disa shteteve në veçanti, historia e Vikingëve, e popullsisë së lashtë norse, popullsisë anglo-saksone, e Europës në përgjithësi, historia e perandorisë ruse etj. Ka shumë aspekte interesante dhe më pëlqen ta "humbas kohën" duke lexuar. Gjithashtu, më pëlqen të dëgjoh lloje të ndryshme muzikash, zhanresh. Nuk ka limit çuditshmëria e gjërave që mund të dëgjoh dhe që të më shijoj vërtetë. Nuk mendoj se mund ta mbyll veten brenda një zhanri. Sigurisht, që ka dhe lloj zhanresh që nuk u afrohem kurrë sepse me të vërtetë që nuk arrij ti shijoj (qesh). Në përgjithësi më pëlqen muzika klasike, rok-klasike, heavy-metal, rok alternativë, pop në një farë mënyre, country në Amerikë etj. Më pëlqejnë këngët e lash-ta vikinge, kam një lloj pasioni të veçantë për këtë kulturë. Gjithashtu, më pëlqen shumë dhe një lloj zhanri i muzikës që po del së fundmi që quhet muzik rok-kinematografik, po ashtu dhe song track (kolona zanor) e ndryshëm të filmave. Ndonjëherë më pëlqen të dëgjosh thjeshtë muzikën e filmave në sfond. Muzika është diçka që merrem shumë në kohën e lirë. Kam një pasion për një serial romanësh dhe që nga 2010

Më në fund! Era dhe Nora Istrefi finalizojnë xhirimet e klipit të ri

Era dhe Nora Istrefi ka kohë që kanë paralajmëruar një duet, ndaj fansat e tyre po e presin me padurim këtë këngë. Përmes rrjeteve sociale, Era ka njoftuar se gjatë ditës së djeshme do përfundojnë xhirimet e videoklipit, kurse kënga do të lançohet shumë shpejt. Në 'Instastory', Era ka sjellë pamje nga prapaskenat e xhirimeve, ku tregojnë ambientin në të cilin po filmojnë. Kujtojmë që ky është projekti i parë i përbashkët i motrave Istrefi. Të gjithë fansat e tyre mezi po e presin.



Ronela Hajati "i nxori" të gjitha, shikoni sa provokuese duket

Ajo është "uragani" Ai skenës shqiptare. Asaj i pëlqen të jetë e drejtpërdrejtë ndaj dhe fansat e adhurojnë. E kemi fjalë për Ronela Hajatin. Bukuroshja ka postuar një fotografi në 'Instagram', në të cilën shfaqet tejet joshëse. Këngëtarja paraqitet e veshur në të zezë, teksa provokoi ndjekësit me të pasmet. Hajati këto ditë po punon rreth projekteve të reja, pasi kish të paralajmëruar që deri në muajin maj t'i publikojë katër të tilla. Kujtojmë që kënga e fundit nga Ronela Hajati është "Vuj", e cila është pëlqyer shumë nga publiku.



I kthyer në një serial televiziv "Game of thrones". I kam lexuar librat dhe historia është fantastiko-shkencore shumë e bukur. Mendoj se një nga arsyet pse më pëlqen është se ka për bazë një histori të Europës mesjetare e pak a shumë pasqyron Anglinë asokohe dhe disa konflikte që kanë ndodhur atje në një formë tjetër me personazhe të trilluara dhe me elemente fantastiko-shkencore. Jam shumë e apasionuar pas këtij universi dhe kësaj historie.

Çasti kur duhet të marrësh një vendim brenda një kohe të shkurtër?

Unë nuk jam person që marrë vendime në kohë të shkurtër sepse më pëlqen që ti planifikoj gjërat. Vendimet që merren në kohë të shkurtër janë ato rezultate i të cilave nuk do ketë ndonjë ndikim shumë të madh në jetën tënde. Mund të jetë një shpenzim lehtëjshëm që dhe aq i madh ose mund të jetë diçka që çdo vendim i mundshëm mund të ketë rezultate të përafërta dhe atëherë thjeshtë e bëj. Në të kundër në qoftë se janë vendime me të vërtetë të rëndësishme që kanë të bëjnë me të ardhmen time apo me gjëra me vlerë për mua nuk do ta merrja kurrë një vendim të shpejtë pa e vrrarë mendjen dhe pa e stërholuar në kokën time.

Muzika dhe arti në çfarë të transformojnë?

Për artin dhe muzikën fola së gjatmi të pyetja e më parshme. Ka gjëra që me të vërtetë i shijoj. Sa i përket muzikës më pëlqen shumë kur dëgjoj diçka që pasqyron



se si ndihem unë së brendshmi. Muzika e fëmijërisë, muzika italiane më krijon rrëqethje në lëkurë dhe më emocionon në tepërmi pasi jo rrallë herë e lidh me kujtimet e fëmijërisë apo dhe thjeshtë talenti që artisti ka. Përpos muzikës kam pasur gjithmonë qejf vizatimit. Është një pasion që e kam lënë pak pas dore këto vite në mungesë kohe. Së fundi, e kam rigjetur veten te ky pasion. Kam tentuar që të merrem me tutoriale se si të rrisin që të shprehësh. Është një mjet i fuqishëm që unë kam në dorë që të shpreh botën time të brendshme në një mënyrë vizuale e ti bëj njerëzit të kuptojnë çfarë ka brenda meje. Më pëlqejnë gjithashtu

novelat fantastiko-shkencore sepse me të vërtetë më bëjnë që të mendoj gjithë ditën se ka një univers paralel, në të cilin imagjinata nuk ka kufij dhe mund të jesh ç'të duash. Duke u kthyer tek pyetja jote do thosha se muzika dhe arti të transformojnë në një genie pa limit, në një genie të lirë. Mund të jesh çfarëdolloj gjëje që ti do; mund të përjetosh të gjitha emocionet që do dhe mund të fluturosh me imagjinatën ku të duash ti. Nuk ka limit të gjërave që ti mund të arrish.

Në retrospektivë si ka qenë fëmijëria jote?

Deri në një farë moshe kam luajtur me fëmijët e tjerë. Pastaj vjen një moment duke

u rritur aty kur mbaron fillorja ndryshon pak rëndësia dhe peshja që ju jep gjërave. Fillon përqendrohesh më shumë te shkolla dhe më pak tek argëtimet. Dua të them që kjo lloj mendësie më ka shoqëruar deri në jetën time prej të rrituri. Kam qenë një fëmijë i problematikë dhe i qetë në përgjithësi. Nuk kam pasur ndonjë fazë të theksuar rebelimi ndaj prindërve, ndaj autoritetit. Në momentin që arrita në shkollën e mesme kam qenë në një fazë që punoja shtatë orë në ditë, pas gjashtë orëve mësim në shkollë.

Asokohe merrja kurse të avancuara në matematikë, fizikë, kimi, përgatitesha për olimpiada. Fundjavat po ashtu sidomos vitin e fundit të gjimnazit e kaloja duke mësuar pasi ndjeja presionin që vinte me maturën dhe përgatitjet për shkollën e lartë. Dua të jem e sinqertë, në fillim të karrierës sime shkollore, në fillorë nuk kam mësuar se kam dashur të mësoj, po kam mësuar se është diçka që duhet bërë. Në momentin që vjen duke u rritur e duke i kuptuar gjërat gjithçka ndryshon. Në shkollën e mesme arrita t'i thosha vetes "Nuk duhet të sëmurem sot, sepse po humba këtë ditë në shkollë do humbas shumë informacion, do humbas shumë gjëra".

Ka pasur shumë situata që kam shkruar në shkollë e sëmurem që të mos humbisja orët. Sigurisht që kam udhëtuar, kam pasur shumë shoqëri në fëmijëri, kam bërë pushime verore, kam kaluar shumë vite pushimesh te gjyshërit në fshat jam kënaqur vërtetë shumë. Gjithmonë në

kohën e lirë dhe në perspektivë me shkollën të gjitha argëtimet kanë zënë një pozicion dytësorë, jo pjesa më e rëndësishme.

Çfarë bën për të mbajtur afër miqtë e tu?

Kam disa miq shumë të ngushtë që janë ende në Shqipëri, kam edhe miq të ngushtë që janë afër, këtu në Gjermani megjithatë në moshën time dhe kur je duke ndërtuar hapat e para të jetës tënde është shumë e vështirë të takohesh shpesh me ta ashtu sikurse je mësuar kur ishe në bachelor. Ajo që mund të bëjë është që të komunikojmë nëpërmjet telefonit thjeshtë për t'i rikujtuar njëri-tjetrit që jemi ende aty, për tu treguar se çfarë ka ndodhur etj. Ka raste që unë nuk dëgjohej me një shok apo shoqe për muaj të tërë dhe pastaj pasi dëgjohej biseda kalon normalisht sikur të kishim folur një ditë më përpara. Kjo mendoj se është një nga ato shoqëritë që tregojnë se është diçka shumë e ngushtë që nuk ka nevojë për një vëmendje konstante 24 orë në 24, por që ti thjeshtë të mbështetesh tek një person i veçantë edhe duke mos qenë aty fizikisht. Dëshira ime është që shoqërinë ta kem afër. Dua të them se kam nisur një lloj fushate për të sjellë këtë një pjesë të personave, me të cilët kam kaluar me të vërtetë momente shumë të bukura në Shqipëri. (qesh) Le të themi se ia kam dalë me shoqen time të ngushtë të gjimnazit, e cila bëri për dy muaj një trajnim në Francë. Nuk është në Gjermani, po fundja fare është shumë afër qytetit ku unë je-

toj Ahen. Në fund të trajnimit të saj më vizitoi për tre ditë. Me personat që kam këtu, shoqja ime e ngushtë jeton në Këln. Komunikojmë përditë, organizojmë gjëra për njëra-tjetrën. E rëndësishme për mua është që t'i tregoj asaj se jam e pranishe kurdo kur ajo ka nevojë për mua.

Arsyja që do të kthehej përfundimisht në Shqipëri?

Të them të drejtën mënyra se si unë i mendoj gjërat është gjithmonë me anë të pozitive dhe negative duke i balancuar gjithmonë. Nëse një vendim ka më shumë anë pozitive se një tjetër atëherë unë bashkoem me këtë vendim. Për momentin vendimi për të ndënuar në Gjermani ka më shumë anë pozitive. Sigurisht nuk jam në vendin tim, mungon ndjenja e të genurit në shtëpinë tënde, nuk kam afër familjen dhe një pjesë të shoqërisë megjithatë kam arritur në një farë mënyre ta bëjë Gjermaninë të ndihet si shtëpia ime. Kam gjetur përditshmërinë, kam gjetur veten dhe mundem që ta përballoj këtë rutinë të përditshme. Kam jetën time, shtëpinë, kam punën dhe jam mësuar më së miri këtu e kështu që nuk e mendoj se është option për mua që të kthehem në Shqipëri. Megjithatë duke i vendosur dhe balancuar gjithmonë gjërat në qoftë se familja ime do kishte nevojë që unë t'u gjendesha pranë në një moment të vështirë atëherë padyshim që do kthehesha, sepse në bilanci e gjërave që kanë më shumë rëndësi ajo është primare. Mendoj se i vetmi rast që do më bënte të kthehesha në Shqipëri është familja.

Publikohet në Fletoren Zyrtare lista me personat që u është njohur e drejta për kompensim

Agjencia e Trajtimin të Pronave publikon listën e 611 me pronarët që kanë aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1993-2013, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilën dosje. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe bëhet fjalë për dosje të cilave Agjencia e Trajtimin të Pronave ka dhënë një vendim. Ndërkohë në 23 shkurt ATP ndërpreu procesin e vlerësimit të dosjeve dhe pronarët që nuk janë njohur me vendimin duhet t'i drejtohen gjykatës.

KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK

Sipas formularëve-tip, mësohet se kërkuesi duhet të

Dosjet 1993-2013, lista me 611 pronarët që marrin paratë

Përfituesit në të gjithë vendin, ja si do të paguhen

cilësorë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet kërkesa për kompensim financiar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës, vërtetim nga gjykata nëse vendimi përfundimtar i vlerësimit të tij është ankimmuar apo jo në rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndry-

shuar rrethi i trashëgimtarëve, prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numër llogarie, vërtetim nëse subjekti ka përfituar ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

LLOGARITJA

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të

kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuar financiarisht si tokë truall përfitojnë kompensim financiar nga fondi financiar i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompen-

sohet fizikisht, nga fondi i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave thotë se subjektet e shpronësuar u nënshtrohen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

LISTA ME 611 PRONARËT QË MARRIN PARATË

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Korçë	Engela Barbuta	2246	3382
Durrës			6890
Elbasan	PETRIT KOÇI	5000	7268
Korçë	Muhamet Xhuli	3780	814.8
Tiranë	BEXHET QAMIL XHIXHABECI	7100	5900
Vlorë	Vasil Qirjazi		2000
Vlorë	Thoma Harrizi	680	120
Korçë	Emine Beta	585.36	203.64
Tiranë	NIKOLLA NISHKU	804	112
Fier	Xhevaire Abedini		5200
Fier	Shkelqim Musaraj		2900
Gjirokastrë	Thoma Dhjamanti	475	475
Tiranë	OSMAN MEMA	181.5	938.5
Tiranë	Nezihat Karapici	132.5	352.5
Elbasan	BAJRAM BOJA		2130
Elbasan	AIR ZHUPANI		1750
Elbasan	BEXHET ZENELI		1200
Fier	Yzeir Qalla	6500	3600
Fier	Sulejman Bejte		4300
Fier	Nedime Roqi		10845
Korçë		87	203.5
Elbasan	MUHARREM BRAHIMI	2377	3372
Elbasan	BEXHET AGOLLI	833	9732
Korçë	Xhevat Mulla		500
Korçë	Ilmi Xhaçi	150	830
Korçë	Marika Andon Prifti		0
Lezhë	Ndue Preng Melushi	2552	27181
Shkodër	Ramiz Jakup Collaku		0
Dibër	DEMIR PALI		6050
Dibër	AKIL BASHA		1700
Korçë	Dhimitër Ziu	1310	590
Tiranë	MUHARREM LILA	325	764
Tiranë	Tiranë TRASHËGIM TARET MANCAKU		4000
Tiranë	ABEDIN GJINI		4600
Korçë	Hysen Hoxha	990	760
Tiranë	HAXHI VATHI	7180	12930
Vlorë	Arshi Devolli		630
Vlorë			15
Vlorë		120	240
Vlorë	Artan Dauti		5000

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Vlorë	Trashgimtarët e Sali Haskaj	5410	3410
Vlorë	Namik Haskaj		90
Elbasan	DINE MIRAKA		3480
Gjirokastrë	Avdulla T affillari		2200
Tiranë	RAMAZAN XHAFA	561	271
Tiranë	BESNIK ETJ T AFMIZI	45	2185
Fier	Demir Skenderi		3600
Fier	Llaqi Jano		800
Fier	Idajet ekmbora		10500
Fier	Arif Lepuri	1361	9639
Fier	azis grecka		4050
Fier	Rrapi Coku		10420
Korçë	Hiqmet Tuxhari	110	283
Lezhë	Aferdita Dolonaku	629	1735
Korçë	Haki Abazi		1041
Korçë	Engjell Zaka, Merjeme Zaka	2618	7463
Korçë	Feride Topollaj, Hyrije Topollaj	903	6067
Durrës	Gjyshata Bektashiane	5019	846
Gjirokastrë	Hasije Hoxhaj	5000	5102
Korçë	Kimet Xhemali Lulo		672
Korçë	Lirim Shtylla		1350
Korçë	Antoneta Starja	168	1120
Vlorë	Kisha Ortodokse	3130	5000
Vlorë	Mamude Rustemi		2800
Vlorë	Hamza Isaraj		2515
Korçë	Lefter Simaku		1374
Korçë	Ferdane Muharremi		1670
Vlorë	Bexhat Shapati	2500	2500
Fier	lili dhami	4815	5435
Fier	mucio buzi	1419	6231
Gjirokastrë	Avni Telhaj		2660
Korçë	Fevri Mulla	1320	180
Korçë	Fevri Muçi	916	1728
Korçë	Elisea Karanxha	2592.5	1634
Korçë	Petraç Stavre		132.55
Fier	Ahmet Nezha	7400	0
Gjirokastrë	Xhevit Ali Sinani	5000	5520
Tiranë	QAMILE NALLBANI	14938	13062
Elbasan	HAVA ALLIU		4043
Elbasan	DYLAVER KRUIJA	5250	750

Fier	Sherif Hazizi		7300
Fier	Tefik Çepele	4767	44890
Fier	Hysen Xhepexhiu		8300
Fier	Sofokli Cuko		3500
Korçë	Hetem Hoxha		2602
Korçë	Esat Muçka		1600
Tiranë	Komuniteti Mysliman	594	673
Korçë	Ali Ibrahimimi	442	2829
Gjirokastrë	Nelo Dedgjoni	4100	11326
Korçë	Azis Manellari	395	445
Gjirokastrë	Jorgo Zerva	1248	450
Gjirokastrë	Veliko Vasili	220	300
Elbasan	ISA BASHA		10600
Shkodër	Gasper Ndoci Kuqani		2900
Shkodër	Provincia Franceskane per Kishat e Dibrës	7450	0
Shkodër	Provincia Franceskane per Kishat e Dibrës	6500	0
Shkodër	Provincia Franceskane per Kishat e Dibrës	4290	0
Shkodër	Provincia Franceskane Shqiptare	3000	0
Korçë	Adil Manelli, Fidan Manelli	188	600
Korçë	Gazi Lindraku		1136
Korçë	Anesti Poçari	699	329
Tiranë	HAXHIRE MJOLLI	42	295.5
Durrës	Zenel Metalla	747	272
Durrës	Nezir Kërtalli		148
Korçë	Qamil Hoxha	194	183
Korçë	Bujar Llabani	150	671
Korçë	Zija Llabani	79	436
Vlorë	Aleksandër Hamzai		5000
Vlorë	Shyqyri Muço		600

Vlorë	Brahim Gaba		2565
Berat	Servet Mali	1900	5920
Elbasan	LILJANA MISIRI	345	195
Korçë	Hasan Fetallari	1526	1256
Korçë	Artan Braholli	476	3584
Tiranë	Jemin Sina		0
Korçë	Kristaq Konini	606.5	583.5
Korçë	Xhevait Murati, Zeni Murati		708
Korçë	Haxhi Kanani	259	218
Korçë	Faik Tare Ago, Seit Ago	568	1122
Korçë	Hasan Kaja, Pëllumb Kaja		280.5
Durrës	Ramazan Çelçima		4810
Elbasan	XHAFERR ASLLANI		0
Gjirokastrë	Masar Fino	975	1252
Korçë	Demiran Hoxha		920
Korçë		100	200
Korçë	Zhani Qirjo	4000	153
Fier	Petrit Cakrani		7224
Durrës	Avdyll Keçi		0
Durrës	Brilant Veseli		476
Korçë	Islam Zyfi		368
Korçë	Agron Taho		400
Korçë	Kico Adham Naumica	234	16
Korçë	Kurti Zeqollari, Zeqir Zeqollari		1905
Korçë	Fazli Elmasllari	803	33
Korçë	Olivera Jovani		1240
Tiranë	FATBARDHA DELIU	2894	5106

Vlorë	Skender Jonuz Jonuzi	8785	1225
Gjirokastrë	Pashun Ruçi	570	300
Tiranë	FATMIR DUMA	37688	52313
Vlorë	Vasil Vasiliu	2500	1600
Tiranë	RUSTEM PETRELA	5000	73533.5
Gjirokastrë	Rakip Kellipi	5526	900
Gjirokastrë	Peço Kagjini	295	300
Korçë	Xhevati Tarelli		374
Korçë	Avni Sali	2835	165
Korçë	FIGAN VASKA	2960	0

Tiranë	FATBARDHA A DELIU	2894	5106
Korçë	Fitret Metolli		228
Tiranë	GAZMEND DIBRA	356	768
Vlorë	Ismet Arapi	640	900
Vlorë	Kujtim Bido	2140	960
Vlorë	Kujtim Bido	2140	960
Vlorë	Sadete Ceno	458	674
Korçë	Anesti Koshho	120	40
Korçë	Anesti Koshho	168	0
Korçë	Anesti Koshho	518	378
Shkodër	Mark Deda		2290
Shkodër	Mark Marku		0
Shkodër	Pjeter Dedaj		1000
Durrës	Seid Daja		5000
Elbasan	JAHO DERMYSHI		3338
Elbasan	SKENDER BUJKU		3540
Elbasan	Bilbil Kala		5760
Elbasan	DASHNOR HARUNI		1250
Gjirokastrë	Beshir Ligaj	462	600
Gjirokastrë	Beqo Hallaci	4919	3015
Gjirokastrë	Petro Adhami		300
Korçë	Sulejman Zyfi		1220
Korçë	Bardhyl Karoli	270	2475
Korçë	Vangjo Bode		740
Korçë	Stavri Stillo	6490	6822.1
Vlorë	Sopot Isufi	2536	664
Vlorë	Kristo Murati	1560	300

Shkodër	Mustaf Xhemali		600
Elbasan	RUSHAN ZANI		1580
Elbasan			460
Elbasan	QEMAL BERDELLIMA	1800	2810
Elbasan	Shqiperie Memetllari		2364
Elbasan	Tafil Dedja		600
Fier	Idajet Haxhiu	5000	12450
Fier	Besim Sefa	1162	1100
Tiranë	IBRAHIM HASNAJ	9390	23532
Tiranë	SEVIM PESHKEPIA	3071	0
Tiranë	EDUARD FEKECI	159.3	705.39
Durrës	Alush Kokalari		200
Durrës	Beqir Troplini		418.5
Kukës	Islam Musli Kastrati		5880
Shkodër	Trash. Xhilaj	6101	0
Durrës	Idriz Cyrbja		1000

Durrës	Janulla Meksi		700
Korçë	Sulejman Mullaj	700	666
Shkodër	Hasan Kaduku		700
Vlorë	Lulëzim Rrapaj		200
Tiranë	Dylbere Sulejmani		90
Tiranë	Dylbere Sulejmani		240
Durrës	Beniamin Ceta		3500
Durrës	Pjerin Shkjezi		7880
Gjirokastrë	Safet Hasani	150	885
Gjirokastrë	Resim Memushi	5000	3105
Korçë	Shaban Isaj		192
Korçë	Andre Simo		119
Durrës	Nexhmi Roshi		4016.9
Fier	Hysen Agalliu		725
Korçë	Bajame Kaso	69.3	950
Shkodër	Paulin Gjon Kiri		0
Dibrë	JAKUP KUKA		2275
Durrës	Sotir Afezollari	2000	1836
Durrës	Kostandin Gajda		2000
Kukës	Sadri Rahman Fetahu	400	2000
Kukës	Syl Bajram Shabani	1758	1200
Kukës	Qazim Abdulla Braha	17360	5000
Tiranë	RAMAZAN XHAFER ABAZI	4850	5694
Durrës	Raif Veli Myshketa	13780	7220
Durrës	Sulejman Kokomani	129	0

Fier	Rije Kiptiu		6000
Fier	Agron Manoku	3145	1855
Fier	Naime Nuri	2000	0
Fier	Hekuran Sefa	1394	4364
Fier	Hazbi Daka	2914	0
Fier	Dilaver Buzi	700	2613
Shkodër	Selim Mehmet Mema		9350
Shkodër	Ndoc Gurashi	3000	4000
Shkodër	Mehdi Kurtalia		93.75
Shkodër	Eshref Kruja	154	596
Shkodër	Cesk Shkoza	1600	0
Tiranë	FADIL DAUTI	125	187
Durrës	Tomorr Sala	97.7	202.3
Elbasan	Maliq Mane		600
Elbasan	NESHAT ISMAILI		2560
Elbasan	SHABAN SARASELI		3980
Korçë	Ali Nuro	992	1313
Korçë	Zalo Taho	390	1660
Korçë		84	0
Korçë	Resmije Pasho		1250
Korçë	Muhamet Alicka	354	2286
Korçë	Muharem Beqillari	920	1668
Korçë	Dane Jaçellari	480	1016
Vlorë	Veli Ballaci	1527	3480
Vlorë	Kasem Hado	724	1316
Durrës	Komuniteti Mysliman		78800
Durrës	Komuniteti Mysliman	168	66
Durrës	Abdulla Kertalli	1734	46269
Gjirokastrë	Mosko Xhillari	242	359
Gjirokastrë	Harallamb Xhillari		298
Gjirokastrë	Fuat Hasani		3317
Korçë	Emine Ajçe	1038	462
Tiranë	SHKELQIM MADANA	145	15
Gjirokastrë	Shamet Lagji	1975	350
Dibër	Xhevdet Daci	398	0
Gjirokastrë	Kaliroi Deçka		1000
Elbasan	Ahmet Coniku		3620
Elbasan	SALI AJAZI		4938
Shkodër	Hysen Barbullushi		156
Durrës	Nikolla Felahi		4800
Fier	Kozma T Anku	10000	22500
Korçë	Kostaq Marko	3668	1530
Lezhë	Pjeter Kola		5050
Tiranë	SHABAN LUGA	12000	8000
Durrës	Viktor Shiroka		810
Elbasan	LEJLA KARAJ		9700
Korçë	Ahmet Keço		156
Korçë	Sami Kodra	80	480
Tiranë		9685	3985
Tiranë	Qemal Hoxha	231	698
Korçë	Nesti Mikani		1956
Durrës	Petraq Papaj	10000	4250
Korçë	Nikollaq Avushka		0
Durrës	Sulejman Cerloi		11772
Shkodër	Eqerem Dushi	3182	0
Durrës	Nafije Halili		0
Elbasan	FAHIK CARCIU		928
Tiranë	ASIM LIKSALA	452	0
Durrës	Asllan Metalla	800	465
Elbasan	Zeqir Biçaku		180
Gjirokastrë	Kristaq Sinani	240	444
Fier	Hidajet Leka		7900
Fier	Tahir Muco		10000
Fier	Beqir Sharka		5000
Gjirokastrë	Petref Xhani		2773
Gjirokastrë	Servet Xhaferaj		971
Korçë	Hiqmet Kodra	44	6630
Korçë	Bexhet Anelli		599

Korçë	Hajdar Mankolli	80.6	1269.4
Korçë	Ymet Merolli		2235
Korçë	Mine Hanelli		324
Gjirokastrë	Mane Aliaj		3000
Korçë		710	400
Korçë	Nimete Pino (Dule)		1500
Korçë	Selami Kreka	300	0
Tiranë	NJAZI DAMANI	512	190
Korçë	Ali Hasankolli		2100
Korçë	Guralije Marelli	1517	470
Durrës			1136.37
Korçë	Fehmi Cangolli		375
Korçë	Nexhmi Bylyku	430	570
Tiranë	EQEREM T SHKESA KISILTA, MAZREKI	176	263
Korçë	Elmaz Dule	130	0
Tiranë	OSMAN SHKOZA	18	148
Fier	Fadil Saraçi		0
Fier	anastas prifti		0
Korçë	Sulejman Alush	682	300
Korçë	Kujtim Cori		1260
Kukës	Kade Bajram Kuliçi		7128
Korçë	Xhezmir Heri	900	1030
Korçë	Inxhi Zypçe	279	371
Korçë	Xhixhe Meraja		760
Korçë	Vullnete Veli		500
Korçë	N uri Diko	1320	680
Korçë	Behije Barolli	1362	963
Korçë	Anesti Kosho		1452
Korçë	Sarandi Vasil Vangjeli	104	200
Tiranë	QAZIM T AFALLA	54	0
Vlorë	Stillo Papadhima		0
Durrës	ASIM HAXHOMI, Esat Haxhomi, Hana Haxhi, Kujtim Haxhollari		5000
Gjirokastrë	Manol Adhami		530
Korçë	Kristaq Pine		397
Korçë	SERVET LARI		4280
Tiranë	HAKVERE ARKAXHIU (BEU)		10000
Tiranë	PETRIT, BESNIK KADIU		1230
Tiranë	ZENEL KRUIJA	104	0
Korçë	Haki Selim		520.9
Durrës			1020
Dibër	Nadire Hiderahmetaj		0
Durrës			1020
Korçë	Ymer Berberi	1362	265.5
Korçë		338	171
Korçë	Tefik Tarelli	240	500
Durrës			3120
Elbasan	FOTI ASIL NIKOLLA	855	8685
Elbasan	BEXHET PAJENGA		280
Korçë	Bardhyl Cane, Dashamir Cane	675	1725
Korçë	MARI FILO		5233
Korçë	Refik Tarelli	1091	1100
Korçë	Bardhyl Cane		716
Tiranë	OSMAN PARUCA	604	0
Tiranë	DONIKA SHELDIJA	15	863
Tiranë	Luftim Gosa		5000
Vlorë	Milo Çipa		200
Shkodër	Keshilli i Kishes Shiroke	1900	860
Elbasan	ADEM BEDALLI	5000	2800
Fier	Xhelo Jancaj	2820	1050
Fier	Haxhi Mishi	7000	3494
Fier	Riza Mirjami	990	878
Korçë	Marigo Naum		0
Fier	Flamur Veliaj		1530
Tiranë	RIZA DIZDARI		10260
Tiranë	JUSUF RECI	13	131
Durrës	Arvanaged Hersi, Myrret Hersi, Bekim Hoxha		7500
Durrës			174

Kryeministri i Kosovës i përgjigjet Federika Mogherinit

Haradinaj: Bisedimet dolën nga binarët me diskutimet për shkëmbim territoresh

HARADINAJ

"Ua kujtoj të gjithë vendimmarrësve se dialogu ka dalë nga binarët shumë kohë para se të vendosej tarifa"

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, tha të mërkurën se bisedimet me Serbinë dolën nga binarët kur shefja e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, lejoi diskutimet për shkëmbim territoresh.

Ai iu kundërvu zonjës Mogherini e cila sërish bëri thirrje për anulimin e tarifave ndaj mallrave serbe, gjatë një fjalimi në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Zonja Mogherini tha se në ditën kur tarifat anulohen, do të organizojë menjëherë një takim për bisedime për të arritur një marrëveshje ligjore që

duhet të zgjidhë të gjitha çështjet e hapura dhe normalizimin e plotë të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

"Siç e dini, personalisht e kam ndërmjetësuar bisedimet, por ato nuk më përkasin mua, as Bashkim-it Evropian dhe asnjëri përreth kësaj tryeze. Bisedimet u takojnë palëve

dhe është në dorën e tyre të gjejnë një marrëveshje që do të ishte e pranueshme dhe e përshtatshme për të dyja palët. Në të njëjtën kohë, marrëveshja përfundimtare duhet të jetë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe duhet të mbështetet nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të

Bashkuara", tha zonja Mogherini.

Por, kryeministrit i Kosovës, Ramush Haradinaj, në një postim në rrjetet sociale, tha se bisedimet nuk janë ndërprerë për shkak të tarifave dhe vazhdimi i tyre nuk duhet të lidhet me to.

"Pas deklaratave të djeshme të Federika Mogherinit, se tarifat duhet të hiqen që të vazhdojë dialogu, unë ua kujtoj të gjithë vendimmarrësve se dialogu ka dalë nga binarët shumë kohë para se të vendosej tarifa dhe kjo ka ndodhur kur përfaqësuesja e lartë e BE-së për poli-



tikë të Jashtme ka lejuar që në këtë dialog jotransparent të diskutohet për ndërrim territoresh dhe me tolerimin e moszbatimit të marrëveshjeve të arritura. Këto janë arsyet se pse dialogu është ndalur", shkroi kryeministri Haradinaj.

Departamenti i Shtetit publikon të dhënat për të drejtat e njeriut në botë

Raporti i SHBA për 2018: Zyrtarët e lartë shmangën ndjekjen penale

"Presion gazetarëve, plumba mbi shtëpinë e Klodiana Lalës"

Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) publikoi dje raportin mbi të drejtat e njeriut në botë. Në pjesën për Shqipërinë trajtohen një numër çështjesh. Ja disa prej tyre:

Mosndëshkimi mbeti problem. Ndjekja penale dhe sidomos dënimi i zyrtarëve që kryenin abuzime ishte sporadik dhe jokonistent. Zyrtarët, politikanët, gjyqtarët dhe personat me interesa të fuqishme biznesi shpesh ishin në gjendje të shmangnin ndjekjen penale. Në përgjigje të kësaj, autoritetet kanë ndërmarrë një veting të monitoruar ndërkombëtarisht të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe kanë skualifikuar një numër të konsiderueshëm zyrtarësh për pasuri të pashpjegueshme ose lidhje me krimin e organizuar.

Korrupsioni vazhdoi të ishte një problem serioz në qendrat e paraburgimit.

Edhe pse qeveria ka mekanizma për të hetuar dhe dënuar abuzimin dhe korrupsionin, korrupsioni në radhët e policisë mbeti problem.

LIRIA E SHTYPIIT DHE E MEDIAS

Media e pavarur ishte aktive dhe shprehu një larmi pikëpamjesh, megjithëse pati përpjekje për të ushtruar presion politik dhe ekonomik të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë mbi median, duke përfshirë kërcënimet dhe dhunë ndaj gazetarëve që u përpoqën të hetonin krimin dhe korrupsionin. Pronarët e bizneseve kanë



përdorur lirshëm mediat për të përfutur favore dhe për të promovuar interesat e tyre pranë partive politike. Shumica e pronarëve të televizioneve private përdorën transmetimet e tyre për të ndikuar në veprimet e qeverisë ndaj bizneseve të tjera të tyre.

Presioni politik, korrupsioni dhe mungesa e fondëve kufizuan mediat e pavarura të shtypit. Gazetarët besohet se praktikuan vetëcensurimin. Pasiguria ekonomike për shkak të mungesës së kontratave të detyrueshme të punës uli pavarësinë e gazetarëve dhe kontribuoi

në anshmërinë e raportimeve. Unioni i Gazetarëve Shqiptarë vazhdoi të raportojë vonesa të mëdha në pagesat e pagave për gazetarët në shumicën e mediave, në disa raste deri në 10 muaj. Problemet financiare i kanë bërë disa gazetarë që të mbështeten më shumë në burimet e jashtme të të ardhurave, duke ngritur pyetje të integritetit.

OJQ-të pohan se etika profesionale ishte një prioritet i ulët për disa nga portalet, që vlerësohet se arrijnë në rreth 700, duke ngritur shqetësime rreth përhapjes së lajmeve të

rreme në përfitim të interesave të veçanta financiare ose politike. Rritja dramatike e mediave në internet solli një larmi pikëpamjesh.

Kriza ekonomike dhe praktikmat e menaxhimit në mediat shqiptare kanë pakësuar financat dhe cilësinë e raportimit në media.

Ka pasur raporte të shumta për dhunë dhe kërcënime ndaj anëtarëve të mediave, ndërkohë që interesat politike dhe të biznesit i vunë gazetarët në presion.

Më 30 gusht, një person i panjohur qëlloi 10 herë në shtëpinë e prindërve të

REAGIMI I PETRIT VASILIT

Departamenti Amerikan i Shtetit foli qarte zgjedhjet e 2017 ishin: Shitblerje vote dhe presion. Nga shitblerja e votes u zgjodh Edi Rama, kjo qeveri dhe deputetet që ndertuan kapjen e shtetit. Ndaj Edi Rama dhe qeveria jane te jashtligjshme. Rrezimi i tyre eshte shpetimi i demokracise dhe i qytetareve.

PORTALET

OJQ-të pohan se etika profesionale ishte një prioritet i ulët për disa nga portalet, që vlerësohet se arrijnë në rreth 700, duke ngritur shqetësime rreth përhapjes së lajmeve të rreme në përfitim të interesave të veçanta financiare ose politike.

reporteres së krimin Klodiana Lala. Zonja Lala raporton shpesh për krimin e organizuar dhe çështjet e zbatimit të ligjit, duke përfshirë reformën gjyqësore. Në shtator, kryetari i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë deklaroi se 12 gazetarë kishin paraqitur kërkesa për azil në vendet anëtare të BE, duke përmendur kërcënime për shkak të vendeve të tyre të punës.

CENSURA:

Gazetarët shpesh praktikojnë vetëcensurim për të shmangur dhunën dhe ngacmimin dhe si reagim ndaj presionit nga botues-

it dhe redaktorët që kërkojnë të avancojnë interesat e tyre politike dhe ekonomike.

Autoriteti për komunikimet elektronike dhe postare dekretoi më 15 tetor se 44 portale të mediave kishin 72 orë për të marrë një numër identifikimi tatimor dhe ta publikonin në faqet e tyre të internetit ose qeveria do t'i mbyllte ato. Lista përfshiu disa faqet e lajmeve humluese, duke përfshirë BIRN. Deri në fund të vitit, qeveria nuk i kishte mbyllur portalet që nuk kishin marrë numrin e identifikimit tatimor.

ÇMIMI

"Skeptri letrar" është çmimi më i rëndësishëm i Shoqatës së Shkrimtarëve të Maqedonisë dhe u ofrohet atyre autorëve, që në veprën e tyre kanë prurje të vlerave të larta estetike.

ARIAN LEKA

Poeti vlerësohet me çmimin ndërkombëtar "Skeptri letrar"

Presidenca e Shoqatës së Shkrimtarëve të Maqedonisë dhe juria e ngritur prej saj shpalli fituesit për çmimit ndërkombëtar prestigjioz "Skeptri letrar". Ky institucion vlerëson me këtë çmim një autor nga poezia europiane dhe një poet maqedonas. Me "Skeptrin letrar" për autorin nga poezia europiane u vlerësua poeti shqiptar, Arian Leka. Poeti maqedonas që meritoi "Skeptrin letrar" është Radovan P. Cvetkovski. "Skeptri letrar" është çmimi më i rëndësishëm i Shoqatës së Shkrimtarëve të Maqedonisë dhe u ofrohet atyre autorëve, që në veprën e tyre kanë prurje të vlerave të larta estetike. Çmimi u dorëzohet fituesve gjatë Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë, që mbahet në Shkup në qershor të vitit 2019. Përveç trofeut letrarë të skeptrit, poetit Arian Leka ky çmim i sjell edhe botimin e një libri me poezi të zgjedhura përkthyer në gjuhën maqedonase, në gjuhën angleze, përballë tekstit në gjuhën shqipe.

Nuk është hera e parë që shkrimtari Arian Leka botohet në gjuhën maqedonase, siç edhe krijimtaria e tij letrare nuk është e panjohur për lexuesit maqedonas dhe shqiptarë që jetojnë në Maqedoninë e Veriut.

Në vitin 2016 romani i tij me titull "Gjarpri i shtëpisë" u publikua nga shtëpia botuese e suksesshme "Goten" me përkthimin e Mirjana Ilieva-Jasharit dhe e shoqëruar me një pasthënie nga shkrimtari i shquar Luan Starova, i cili shkruan: "Arian Leka, me veprën e tij poligrafe letrare si poet, tregimtar dhe romancier, eseist, përbën gjeneratën më të re të shkrimtarëve shqiptarë e cila çlirohet në mënyrë radikale nga socrealizmi, duke iu afruar poetikës së romanit modern evropian".

Më herët poetizë e këtij autori, të përkthyer në gjuhën maqedonase nga Resul Shabani janë paraqitur në Festivalin Ndërkombëtar të Strugës dhe janë botuar në revistën letrare "Sintesi".

Ese të tij mbi multikulturalizmin dhe muret e dukshëm dhe të padukshëm mes kulturave në Ballkan dhe në Europë, janë mirëpritur nga kritika dhe lexuesit pasi janë botuar në revistën "Stozher", nën përkthimin e Daim Miftarit.

Vlerësim për krijimtarinë në prozë të Arian Lekës ka shprehur edhe kritikja e njohur letrare Elizabeta Sheleva, e cila ka përjasur



“
Me "Skeptrin letrar" për autorin nga poezia europiane u vlerësua poeti shqiptar, Arian Leka. Poeti maqedonas që meritoi "Skeptrin letrar" është Radovan P. Cvetkovski. "Skeptri letrar" është çmimi më i rëndësishëm i Shoqatës së Shkrimtarëve të Maqedonisë.

modalitetet e babait në letërsinë maqedonase me shembuj të krahasueshëm nga rajoni i Ballkanit. Po ashtu, është mirëpritur edhe tregimi "Pema", i përkthyer në gjuhën maqedonase nga Fatbardha Shehu, për të cilin shkrimtari dhe kritikur letrar Srđjan Srdi? ka shkruar se kjo prozë e ciklit të tregimeve të Arian Lekës mbi fatin e emigrantëve shqiptarë pas vitit 1991 dhe të atyre që masivisht braktisin një nga vendet më të varfra të Europës në fund të shekullit të shkuar, në kërkim të strehës përtej Atlantikut, por edhe në Italinë fqinje, ndërtohet me tekste pakrahasimisht më të dhimbshëm, të tillë që shkaktojnë hidhësi dhe ngarkesë leximi, për shkak të identifikimit të drejtpërdrejtë dhe të papenguar me viktimat historike të padyshimit, nga të cilat nuk ka pak anekënd Ballkanit. Nga perspektiva e një femije tregimi "Pema" shpreh jo vetëm tmerrin që përndjek emigrantët, por i kontribuon drejtpërdrejtshëm, si edhe zmadhimin të mundimeve para tablove të natyrës njerëzore, të pandregshme dhe të këqija.

Por veçmas të tjerave, vlerat e poezisë së Arian Lekës janë shprehur përmes krijimtarisë kushtuar detit dhe marrëdhënieve të shqiptarëve me detin dhe të njeriut, si genie universale, me të. Duke u

shprehur për krijimtarinë e tij Luan Starova shkruan: "Rrënjët e Arian Lekës në jetë dhe në krijimtarinë janë atje, në Durrës, përgjithmonë mes bregut dhe detit, por më shumë në det se sa në breg. Atje ai i përjeton çastet parajsore të fëmijërisë, por edhe ferrin e rinisë për shkak të mosqasjes në det në të gjitha dimensionet e tij. Siç edhe gjendet dendur edhe në tekstin e tij, Arian Leka kujtohet se regjimi, në një periudhë e "robëroi detin", e bëri të rrezikshëm për njerëzit, vendosi atje tre kufij në ujëra, deri në barrierën e parë, përkatësisht kufi prej qindra metrash ku nuk mund të notohej lirish, dhe ku rrallëkush guxonte të arrinte deri tek i treti, ndërsa nëse hynte tek i treti bëhej pre e sigurt e "Sigurimit", i cili e priste viktimën si kuçedër e fshehtë shumëkokeshe. Por, më të fuqishmen për kohën, ndërmyjet bregut dhe detit, më shumë të bregut se sa të detit, Arian Leka do ta përjetësojë me shumësinë kuptimore të metaforës në poezinë e tij "Shpina e detit"...

Njerëzit e mi ia kthyen shpinën detit
Dhe unë kam të njëjtën dobësi
i mbysnijet
i shpoj në brinjë dhe iki larg
aty ku retë më kujtojnë peshqit
çdo varr është flugë me velë të bardhë

REGJIMI

Arian Leka kujtohet se regjimi, në një periudhë e "robëroi detin", e bëri të rrezikshëm për njerëzit, vendosi atje tre kufij në ujëra, deri në barrierën e parë, përkatësisht kufi prej qindra metrash ku nuk mund të notohej lirish, dhe ku rrallëkush guxonte të arrinte deri tek i treti, ndërsa nëse hynte tek i treti bëhej pre e sigurt e "Sigurimit", i cili e priste viktimën si kuçedër e fshehtë shumëkokeshe.

atje ku çdo pemë rrit pemët në bark dhe anije
ikin anijet
njerëzit e mi i kthyen shpinën detit

dhe nxjerrin zorrët
veç nga e ëmbla bukë e tokës
dhe nga pijet.

Arian Leka është autor i disa librave me poezi, prozë, ese dhe studime letrare. Krijimtaria e tij letrare është nderuar me 4 çmime kombëtare nga Ministria e Kulturës si librat dhe dorëshkrimet letrare më të mirë të vitit (Strabizëm 2004; Shpina e burrit, 2006, Ndrejje gabimesh 2010; Dora e majtë, 2016). Tregimi i Arian Lekës "Vëllezër në brisk" u bënë pjesë e antologjisë së mirënjohur "The Best European Fiction 2011" (USA). Në vitin 2014, eseja e tij "Këmisha" u bë pjesë e antologjisë europiane "Das Hemd" (Graz, Austri). Në vitin 2017 tregimi "Qeli prej letre" u përfshi në antologjinë "Glückliche Wirkungen" (Berlin, Gjermani) dhe në vitin 2018, tregimi "Paranoja" u botua në antologjinë "Europiani i mirë (Mynih, Gjermani).

Poezitë e Arian Lekës janë botuar si libra më vete në gjuhën frënge (L'il qui chasse) përkthyer nga Edmond Tupja, në gjuhën gjermane (Ein Buch Ein Meer), përkthyer nga Lindita Arapi dhe Loreta Schillock, në gjuhën rumune (Biblioteca plutoiare), përkthyer nga Ardian-Christian Kyçyku. Këto poezi janë botuar në antologji të shumta në gjuhë angleze, italiane, sllovene, gjermane, serbe, kineze, kroate, finlandeze si dhe në mjaft revista letrare, mes të cilave edhe "Poem" me editore poeten e shquar britanike Fiona Sampson.

FËMIJET E SHKRIMTARIT

"Ishe i talentuar vëllai im, por nuk të pëlqente asnjëherë të ishe hije e pemës së madhe e të harlisur, hije e babit tënd"



Letra e ndjerë e vajzës së Agollit për vëllain: Vuaje për babin, ishe hija e tij

Elona Agolli, vajza e shkrimtarit Dritëro Agolli ka bërë dje një postim të ndjerë në "Facebook".

Dy vite pas ndarjes nga jeta të Dritëroit dhe pak ditë pas ndarjes nga jeta të nënës Sadije, ajo i kujton vëllait porositi që u kanë lënë prindërit. "Jeni bashkë, duajeni njëri-tjetrin, mos u ndani kurrë në dhimbje e në gëzim", na thoshin. Vëllai im, motra të do fort. Bashkë do vijojmë të përmbushim ato pengje e amanete të prindërve. Bashkë do luftojmë që emri i prindërve tanë të kujtohet ngaherë", shkruan Elona. Ajo nxjerr në pah edhe talentin e të vëllait në letërsi kur shkruan se, "frymëzoheshe i vogël duke parë babin e nise të shkruaje edhe ti. Fletoret i fshihje pasi kishe drojë nga babi autoritar. Poezitë e tua qarkullonin dorë më dorë e mësoheshin përmendësh nga shokët e tu". Por, sjell në vëmendje edhe kohë të vështira që ka kaluar familja e tyre. "Rinia të erdhi e trazuar. Vite të dhunshme. Tronditje, shkundje sistemesh, shembje e kulturave dhe standardeve të komunikimit shoqëror: Vuaje deri natën vonë ulërimat dhe sharjet hysterike ndaj babit. Prekeshe shumë, ishe i ndjeshëm dhe zgjodhe të largoheshe". Djali i të ndjerit Agolli ka preferuar gjithnjë të qëndrojë në heshtje, duke ruajtur profil të ulët publik, ndonëse prindërit e tij kishin vëmendjen e mediave dhe botës intelektuale në vend.

Më poshtë, fjalët së motrës.
POTIMI I PLOTË I ELONA AGOLLIT

Elona zbulon talentin e fshehur të vëllait, që kishte drojë nga i ati



**13 Mars
Tanit, vëllait tim,**

Babi të thërriste përherë Artan, nuk i pëlqente të shkurtonte emrin. Dhe emri yt i bukur e ka një histori, histori e lidhur me një miqësi të fortë të prindërve tanë me Xhaxhi Endrin (siç e thërrisnim fëmijë Endri Kekon) dhe teta

Xhanon (Xhanfize Keko). Atë ditë që llnde ti babi shkruante poezinë "Vëllai" (Një njeri të vockël mamit se kush ia dha të vockël sa s'qëndron dot në këmbë. Babi thotë se është tri pëllëmbë e ca, Po ç'ne! Nuk është as dy pëllëmbë!) Atë ditë, gjyshja ime e mençur, Xhexheja, fluturonte nga gëzimi

dhe kurorëzim të këtij shendi kishite vënie e emrit. Dhe ajo duhej t'i paraprinte "dinastisë shkodrane", siç e quante me të qeshur fisin e mamit. "Shpejt Endri, t'i vemë emrin djalit, se na takon neve, apo jo?"

-Epo ta gëzojë, Artani emrin. Xhaxhi Endri e kishte në mend dhe menjëherë ai nuk e bëri dysh fjalën e gjyshes sonë dinake e të mençur.

Kështu vëllai im, u rritëm fëmijë të gëzuar, me prindër të rrallë (disi edhe na mungonin pasi dashuria për ne kishte një konkurrent të madh, dashurinë për krijimin, poezinë letërsinë). Orët e pagjuma të babit i ndjenim përmes traktukut të makinës së shkrimit, përmes mjegullit të dendur të tymnajës së cigares (oxhaktore e madhe do duhej-thoje shpesh, që të thithte tërë këtë tym). Frymëzoheshe i vogël duke parë babin e nise të shkruaje dhe ti. Fletoret i fshihje pasi kishe drojë nga babi autoritar. Poezitë e tua qarkullonin dorë më dorë e mësoheshin përmendësh nga shokët e tu.

Ishe i talentuar vëllai im, por nuk të pëlqente asnjëherë të ishe hije e pemës së madhe e të harlisur, hije e babit tënd. Ishe edhe rebel, i thojë hapur pakënaqësitë e jo pak herë ke provuar qortime edhe të rënda nga babi. Duhet të rriteshe edhe më, që të flisje e mirëkuptoheshe hapur fare, me babin. U bëtë shokë më pas. Kur babi shkonte jashtë Tirane, në rastet kur mami nuk e shoqëronte, shkoje ti. I mban mend Dajtin, Shëngjinin, Velipojën, Dhërmiun,

Vlorën, aty ku babi shkruante apo përfundonte veprat e nisura?

Rinia të erdhi e trazuar. Vite të dhunshme. Tronditje, shkundje sistemesh, shembje e kulturave dhe standardeve të komunikimit shoqëror: Vuaje deri natën vonë ulërimat dhe sharjet hysterike ndaj babit. Prekeshe shumë, ishe i ndjeshëm dhe zgjodhe të largoheshe. Kalove si shumë të tjerë vite të vështira larg familjes. Letrat e mamit ishin të panumërta: poezitë e babit po ashtu (mbase kujtohet im bir arratisur në botë, dhe prish heshtjen e dhjamur mbi letrat! Ah, kjo cigare që pi është e fortë, e ndiej kur në gjoks më shtrëngon - poezia 'Pritja'). Edhe motra vuate largësinë e vëllait. Kaluan vite, krijove familje, përjetove dhimbjen e humbjes së babit, e atë që nuk e kishe menduar kurrë, edhe largimin nga jeta të mamit.

Ishim përgatitur të festonim këtë 50-vjetor tëndin të gjithë së bashku, të gëzonim mamin e të ngrinin dollin. Por mami na la. Nuk prit dot, shkoj pranë babit. "Jeni bashkë, duajeni njëri-tjetrin, mos u ndani kurrë në dhimbje e në gëzim" - kështu na këshillonte ngaherë. Vëllai im, motra të do fort. Bashkë do vijojmë të përmbushim ato pengje e amanete të prindërve. Bashkë do luftojmë që emri i prindërve tanë të kujtohet ngaherë. Gëzuar datëlindjen, vëllai im! Numri 13 për ne është fatsjellës, pasi festojmë dy data të shënuara, datëlindjen tënde në pranverë dhe datëlindjen e babit në vjeshtë. Rrofsh vëllai im.

Opinion i Ditës

Zgjedhjet europiane, sondazhet dhe negociatat

Nga Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

... ndodh në 40-vjetorin e zgjedhjeve të tij të para të drejtpërdrejta dhe përvjetorin e 30-të të shembjes së Murit të Berlinit.

Por, vështirë të ishte menduar se për shkak të krizave, konfliktëve, Brexit dhe dukurive të tjera serioze të njohura tashmë, këta dy jubile historikë do ta gjenin BE-në dhe vetë Parlamentin Evropian në gjendjen më të nderë.

Ndërkohë, pavarësisht nga premtimet dhe thirrjet për mobilizim në vende të ndryshme, ende shumë pak lëvizje politike efektive dhe frymëzuese po bëhen nga forcat e moderuara politike përballë ofensivës agresive të partive populiste dhe ekstremiste anti-evropiane. Dhe projekti i Evropës së Re, që presidentin francez Macron lançoj më 5 mars ka hasur në shumë kundërshtime, duke përfshirë edhe "binjakën" e tij evropiane, Gjermaninë.

Këtë gjendje të amullt e konfirmojnë edhe disa sondazhe, të cilat nuk të "ngrohjin" aspak dhe tani kur këto zgjedhje po trokasin te portat e BE-së.

Sot po ndalemi me disa komente të shkurtër në sondazhin e fund javës së kaluar të institutit të specializuar gjerman "INSA" në bashkëpunim me homologë të tij në gjashtë vende kryesore të BE-së. E reja tronditëse që pritet të ndodhë sipas këtij sondazhi më 26 maj, është rritja e ndjeshme e numrit të eurodeputetëve nga forcat populiste, ekstremiste dhe euroskeptike, që po grupohen së bashku në Europarlamentin e ri. Vendin e parë e zë "Lëvizja Evropiane e Kombeve dhe Lirisë", që pritet të sigurojë 65 ose 37 vende më shumë se në 2014-ën, kur u themelua. Liderja tradicionale këtu është "Bashkimi Kombëtar" i Le Penit, që në zgjedhjet presidenciale 2017 në Francë fitoi 23 për qind të votave.

Po kështu mund të thuhet për pritshmëritë e "Lega Nord", që në zgjedhjet një vit më parë në Itali fitoi 33,4 për qind, duke "përzënë" nga qeveria social-demokratë bashkë me Lëvizjen e Majtë "5 Yjet". Aleatë të tjerë të këtij koalicioni janë FPO-ja austriake me 24 për qind, e cila qeveris prej mbi një viti me konservatorët. Po ashtu, PIS në pushtet në Poloni ka 42 për qind të votave si dhe tri vendet e tjera të Visegradit.

Kjo Aleancë e ekstremit të djathtë ka fituar në vendet e ndryshme, kryesisht për shkak të grabimeve dhe dështimeve të partive tradicionale në përballimin e krizave të mëdha financiare si në Itali, Spanjë, Greqi, Portugali dhe Gjeokë. Duke qenë për një periudhë



të gjatë në opozitë, ato e kanë fare të lehtë të bëjnë kritika, denonci me, protesta, ankesa. Ndërkohë, në vend të alternativave bindëse nxitonë me deklarime dhe premtime joshëse të paralizueshme, por që tingëllojnë "muzikë" në veshët e elektoratit të zhgënjyer me partitë tradicionale.

Por, objektivi i tyre është që në aleancë me grupime të tjera të bëjnë të mundur të fitojnë 1/3 e vendeve në Europarlament, duke ua vështirësuar jo pak jetën dhe punën dy partive tradicionale dhe institucioneve evropiane.

Futuesit e dytë të mëdhenj pritet të jenë liberalë/demokratë evropianë (ALDE), të cilët sipas sondazhit do të sigurojnë 101 eurodeputetë nga 68 që kanë aktualisht. Kjo shpjegohet kryesisht me rolin e partisë centriste "En Marche" të presidentit Macron; gjithësesi, duke pasur parasysh protestat e dhunshme të muajve të fundit në Francë ka vend për dyshime në rezultatit e tyre të pritshëm.

Efekt tjetër pozitiv japin liberalët në Gjermani, Holandë, Belgjikë dhe në vende të tjera, që kanë kapur kuotat 20 për qind. Nisur nga roli dhe profili i tyre i theksuar evropian, ky përbën lajm të mirë për të djathtët e moderuar.

Të Majtë (komunistët e reformuar) parashihet të kenë 29 ose vetëm një eurodeputet më shumë se më 2014, duke pasqyruar "vendnumëro-në" e tyre politike pothuajse kudo ku janë aktivë. Madje, ata kanë humbur pozitaz drejtuese edhe në ish-lindjen gjermane, duke ua lënë vendin ekstremistëve të "Aleanca për Gjermaninë" (AfD), që me mbi 10 për qind, parvjet u fut për herë të parë me 93 deputetë edhe në Bundestagun gjerman.

Atyre u kanë "hyrë në pjesë" dhe forca të tjera të majta ekstremiste si "5 Yjet" italianë, ata spanjollë, belgë, grekë etj.. Dy javë më parë, këto të fundit vendosën krijimin e një aleance të re majtiste, që do të konkurrojë më 26 maj.

Sipas sondazhit të lartpërmendur, dy humbësit më të mëdhenj do të jenë Grupi i Partive Popullore (EPP) dhe i Social-Demokratëve Evropianë (S&D).

EPP do të humbasë minimumi 43 vende të Europarlament nga 217 që ka tani. Kjo, si pasojë e mungesës së Britanisë së Madhe, konservatorët e së cilës zinin një pjesë të madhe, rënies së ndjeshme të CDU/CSU-së gjermane, që gjithësesi është në pushtet e sidomos të atyre italianë, francezë, spanjollë etj.. Qenia për një kohë të gjatë në pushtet dhe mospëballimi efektiv i krizave të njohura dhe skandalëve të ndryshme kanë çuar në gërryerjen e ndjeshme të terrenit të së djathtës tradicionale në politikën e tanishme. Shkak tjetër është largimi i partisë "Fidesz" të Viktor Orban nga EPP, që mund t'i shkaktojë EPP-së humbjen e 13 vendeve të tjera në Europarlament.

24 vende pritet të humbasë edhe Partia e Konservatorëve Reformatorë (ECR) nga 75 që ka, kryesisht për shkak të largimit të Britanisë së Madhe.

Edhe Të Gjelbërit do të humbasin 8 nga 52 që kanë aktualisht. Kështu, rritja e tyre në Gjermani dhe në Belgjikë nuk sjell ndonjë ndikim të madh përballë vendeve të tjera ku ata janë në rënie.

Gjithësesi, gjasat më të shumta janë që humbësi më i madh të jetë Aleanca Progresive e Socialistëve dhe Demokratëve (S&D) që mund të humbasin mbi 45 vende, nga 195

që mbajnë aktualisht dhe me vështirësi do ta mbajnë vendin e dytë, nëse nuk do të ketë surpriza edhe më të pakëndshme për ta.

Kjo, për shkak të mungesës së social-demokratëve britanikë dhe gjendjes së tyre katastrofike pa rrugëdalje. As "me gisht nuk numërohen" partitë social-demokratë në pushtet, me përjashtim të Gjermanisë, ku janë prej vitesh në koalicion, por kur kanë rënë në nivelin më të ulët historik me 15 për qind; në Rumanisë skandalësh të shumta, në Suedi me koalicion dhe në ndonjë vend tjetër: Edhe në Spanjë u ishin për disa muaj në qeveri, pritet të bien në zgjedhjet e reja të parakohshme.

Kurse në Francë, Itali, Poloni, Portugali, Holandë, Greqi dhe gjatë social-demokratët janë në kufijtë e mbijetesës politike, duke humbur kështu edhe karakterin si "parti popullore" dmth, masive. Dhe forumet e tyre drejtuese evropiane dhe botërore, PSE dhe IS nuk mund të ndihmojnë dot, sepse liderët e tyre të panjohur përfaqësojnë vende humbëse si Bullgaria, Greqia, Holanda, etj.

Ky dështim spektakolar është pasojë e largimit të tyre të skajshëm nga mbrojtja e shtresave sociale tradicionale që përfaqësojnë, rinia dhe studentët, pensionistët dhe të papunët. Ato kanë bërë kauzë të përbashkët me të djathtët kryesisht reformator, shkurtimet dhe kursimet, rritjen ekonomike, por me pabarazi në rritje; për pasojë, barra e krizës ka goditur sa nuk mban më elektoratet dhe simpatizantët e tyre. Së fundi, mungesa e liderëve karizmatikë, vizionarë dhe të besueshëm është dhe më dekurajues për të ardhmen e këtyre partive. Schröder, Blair, Gonzales, D'Alema, Jospin, Kvasniewski, Rasmussen,

A.Papandreu kanë mbetur kujtime të largëta dhe pa pasardhës të denjë si asnjëherë më parë.

Për pasojë, dy partitë e mëdha që tradicionalisht kanë siguruar shumicën e votave me një konsensus të përhershëm rrezikohet të humbasin "hegemoninë" e tyre. Kështu, ata do të detyrohen t'u luten për ndihmë forcave të tjera, sidomos Liberalëve ose të Gjelbërve, për të vijuar këtë traditë vendimmarrëse. Mirëpo kjo do të ketë pasojat e veta në procedurat e gjata të miratimit të Presidentit të Komisionit Evropian, të Këshillit dhe të Shërbimit të Jashtëm si dhe në gjithë vendimet e tjera.

Në këto kushte, gjatë këtyre 70 ditëve të mbetura, vëmendja e 27 vendeve anëtare të BE-së do të përqendrohet tërësisht në betejën jetike zgjedhore, programet, emrat e kandidatëve, logot, me një katalog tematik të superngarkuar si asnjëherë.

Aty mungon zgjerimi evropian, sepse kjo temë tashmë nuk është "sexy", nuk frymëzua kënd dhe kryesorja nuk jep vota, por vetëm "dhimbje koke".

Ndaj, dhe gjasat për vendimin për çeljen e negociatave në qershor janë natyrshëm në minimumin e vet, por jo të pamundura, sidomos nëse më 26 maj do të ketë surpriza të favorshme për partitë tradicionale pro-evropiane dhe mbi të gjitha, të dyja krahët e politikës te ne do të bëjnë ndonjë "mrekulli" për qartësimin dhe qetësimin e gjendjes së brendshme, pa i bërë kursesi "kurban" negociatat. Ndryshe, "namin" të bëjë Komisioni dhe Parlamenti Evropian, pa "Po"-në e secilit vend anëtar dhe performancën tonë nuk mund të ketë çelje negociatash.

Ndonëse në MPJ-në në Tiranë ka stafë të specializuara dhe me përvojë për negociatat, kurse në Bruksel kemi një përfaqësi diplomatike model, tejet e aftë dhe të përkushtuar, me një ambasador të kundërdodhur dhe 100 për qind e stafit diplomatik karriere, që gëzojnë respekt në institucionet evropiane, në Belgjikë dhe Luksemburg, sërish kjo nuk mjafton.

Gjithësesi, edhe nëse na ikën qershori, janë të gjitha gjasat që ky vendim të merret në veshjet dhe negociatat të çelen në fund të vitit. Ndaj, me të drejtë, krahas MPJ-së, edhe Kuvendi, Presidencia, edhe dikasteret e linjës po punojnë intensivisht në këtë drejtim; kjo do të bëjë të mundur që kur gjithçka të jetë qartësuar dhe të kenë filluar nga puna institucionet e reja evropiane në veshjet, Shqipëria të pohojë me gojë plot "jemi gati" dhe Këshilli i BE-së të na thotë "Mirë se vini". Aq më tepër që më 1 janar 2020, Shqipëria do të marrë edhe kryesimin e OSBE-së.

Opinioni / Ditës

Nevoja për një strategji të ndershme të opozitës

Nga Neritan Sejmani

(vijon nga faqja 1)

...normale, edhe pse pa opozitë. Prioriteti i menjëhershëm i tij është mbushja e vendeve parlamentare të braktisura nga opozita me zëvendësues po nga listat e opozitës, për të krijuar një "opozitë të re", e cila do të përdoret për të dhënë pamjen e një parlamenti dhe qeverie që funksionojnë dhe qeverisin normalisht.

Duket se zoti Rama do të arrijë me siguri të plotë vetëm 18 deri në 25 nga 59 vendet e mbetura bosh në Kuvend nga listat e partive parlamentare opozitare. Mbas shërimit të listave opozitare, ligji i jep atij mundësinë të fusë kandidatët nga listat e PS-së, por me gjasë kryeministri nuk do të arrijë deri këtu.

Ky thajse-Kuvendi, i përbërë nga afërsisht 100 deputetë, nga 140 që përcakton Kushtetuta, do të vazhdojë "rregullisht" jetën parlamentare, do të shqyrtojë projektligjet në komisione, do të zhvillojë debate plenare dhe do të miratojë ligje.

Për të rritur besueshmërinë, zoti Rama do të përpikt të sigurojë mbështetjen e fuqive perëndimore për këtë "rregullim" parlamentar, duke i joshur ata me miratimin e reformave që ata i mendojnë të domosdoshme.

Në krye të listës është reforma zgjedhore, kusht për hapjen e negociatave me BE-në. Për hartimin e saj, zoti Rama duket se do të imitojë qasjen e ndjekur me reformën në drejtësi: do ta shpallë reformën prioritet, duke e propaganduar kudo, do të bëjë aleatë përfaqësuesit perëndimorë, duke përfshirë formalisht ekspertë të tyre në hartimin e saj, ndërkohë që kontrolojnë vetë procesin e përbajtjen e reformës dhe pastaj do të denoncojnë opozitën që nuk është bërë pjesë e reformës, duke nxitur edhe kritikën e të huajve ndaj saj.

Pak ditë më parë, zoti Rama e pohoi në Kuvend këtë synim, duke u shprehur se ai do të hartojë dhe miratojë reformën zgjedhore bashkë me "opozitën e re". Ndërsa dje, ambasadori i OSBE-së në Tiranë shprehu mbështetjen për këtë strategji të kryeministrit, duke pohuar se miratimi i reformës zgjedhore nga Kuvendi është i ligjshëm, përderisa ai ka të paktën 84 deputetë e nevojshëm për ta miratuar.

Duket se zoti Rama do të bëjë edhe një manovër tjetër taktike, që do të largojë vëmendjen nga kriza dhe do t'i sjellë përfitimë politike - do të miratojë të drejtën e votimit nga jashtë Shqipërisë, pra votimin e emigrantëve. Më këtë veprim, ai do ketë arsye për të bërë propagandë vetëlënduese pseudopatriotike



dhe do të marrë mbështetjen nga emigrantët, ndërkohë që ka kontroll mbi administrimin e votimit të emigrantëve përmes ambasada- dave shqiptare.

Kështu, zoti Rama do të mund të krijojë një "normalitet" politik të paktën për disa muaj, por ai e ka të qartë se gjithsesi, kriza politike do të çojë, herët a vonë, në zgjedhje.

Duke shfrytëzuar gabimin e opozitës, e cila vazhdon t'i harxhojë energjitë në protesta dhe denoncime, kryeministri po përgatit me shpejtësi partinë e tij për zgjedhje, për të qenë gati që të detyrojë mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme në kohën më të përshtatshme për të, duke befasuar opozitën e papërgatitur.

Madje, nëse opozita do të mbetet e tularur dhe socialistët arrijnë të mirëpërgatiten, ka një gjasë që kryeministri Rama të japë dorëheqjen, sikurse kërkon opozita, për të kontrolluar qeverinë edhe zgjedhjet pa pasur nevojë për karrigen e kryeministrit.

Zoti Rama duket se do të synojë fillimisht të mbajë zgjedhjet lokale të planifikuara për në qershor, pavarësisht se opozita me siguri nuk do të marrë pjesë në to.

Për të krijuar idenë e zgjedhjeve pluraliste, ai do të përpikt të spon-

zorizojë kandidatët të pavarur, të ringallë parti që ekzistojnë vetëm në emër, apo të nxisë krijimin e partive të reja nga grupime të shquara për veprimtarinë shoqërore.

Përveç krijimit të fasadës së zgjedhjeve pluraliste, me këtë veprim kryeministri shpreson singlerisht se ndoshta ndonjë nga grupet që ai do të nxisë mund të rritet aq sa të konkurrojë, dobësojë apo zëvendësojë një apo disa nga partitë e opozitës. Kjo dëshirë është artikulluar publikisht nga surrogatët mediatikë të kryeministrit, me qëllim ngjalljen e panikut tek ndjekësit e opozitës dhe nxitjen e grupeve që duan të aktivizohen politikisht.

E gjitha kjo "strategji normaliteti" po shogërohet me propagandë të theksme, e cila synon kryesisht opinionin e huaj politik dhe diplomatik, si element kritik për suksesin e strategjisë.

Megjithatë, mundësia e suksesit të strategjisë duket e vogël. Përtej propagandës, gjendja e vërtetë politike dhe ekonomike është e rëndë dhe në disfavor të Kryeministrit. Mbi të gjitha, koha është në disfavor të tij, veçanërisht faktit se kryeministri është në mes të mandatit të dytë dhe ai nuk shihet si zgjidhje e qën-

drueshme, pasi mandat i tretë duket për shumëkënd thajse i pamundur.

Mbi të gjitha, nëse opozita bën atë që duhet të bëjë-ndërton dhe ndan me qytetarët një vizion që synon një ndryshim të vërtetë dhe të thellë për të prishur pikërisht "normalitetin" politik, ekonomik dhe shoqëror të tre dekadave të fundit-gjasat e suksesit të Kryeministrit bëhen më të vogla.

Në të vërtetë, opozita duhet ta tronditë "normalitetin" duke e polarizuar elektoratin, duke e ndarë atë me pykë në dy pjesë - në njërin anë populli dhe në anën tjetër kryeministri Rama dhe elita e tij e korruptuar.

Kjo gjë kërkohet që opozita të marrë qëndrime parimore dhe të ndershme, duke hequr dorë nga logaritë dhe taktikat me makina- cione, duke pranuar të vërtetën se e keqja nuk është vetëm kryeministri, por edhe elita e përhershme, e cila qëndron gjithmonë në krah të pushtetit për të përfituar në bashkëpunim me të në kurriz të njerëzve.

Në politikë nuk qëllon shpesh që rruga e ndershme dhe ajo pragmatike të përputhen, por këtë herë rruga që e çon opozitën në pushtet është rruga e ndershme.

Exit.al

HOROSKOPI

DASHI

Të lindur e kësaj shenje do të zhvillojnë një bisedë të vështirë. Do t'ju duhet t'i përgjigjeni dikujt me të cilin keni vepruar në mënyrë të padrejtë. Edhe në aspektin profesional ka gjasë të përballeni me stres. Shmangni konfliktet me kolegët dhe mos veproni kundër shefave.

DEMI

Demat duhet të shohin me kujdes mënyrat për të zgjidhur problemet. Çdo gënjesh-tër do të zbulohet lehtësisht. Respektoni të tjerët dhe shmangni arrogancën. Sa i përket jetës në çift, do të kaloni një ditë rrafit të mirë.

BINJAKET

Binjakët do të zbulojnë disa sekrete në lidhje me një të afërmin tuaj. Nëse ky informacion nuk ju shqetëson, përpiku të harroni gjithçka. Merruni me punët tuaja dhe riktheni rregullin në jetën personale.

GAFORJA

Do të ndiheni shumë optimist gjatë ditës së sotme. Një telefonatë do t'ju gëzojë pam-asë, pasi do të merrni një lajm që ju e pris-nit prej kohësh. Ka gjasë që gjatë kësaj të enjte të takoni persona me të cilët ndani të njëjtat interesa.

LUANI

Luanët do të tregohen shumë strikt ndaj vetes gjatë ditës së sotme, por edhe ndaj një personi të ngushtë. Sa u përket finan-cave, nuk do të keni shumë ndryshime. Nuk është dita e duhur për të bërë deklarata dashurie.

VIRGJERESHA

Nuk rekomandohet të merrni përgjegjësinë e të tjerëve. Rrezikoni që t'ju dëshpërojnë fjalët dhe si pasojë mund të shkaktohen probleme. Sakri-ficat për të tjerët do t'ju sjellin humb-je të mëdha.

PESHORJA

Peshoret duhet të shmangin thasheth-emet, pasi mund të bëheni pjesë e një konflikti. Bëni kujdes dhe tregojuni ven-din personale që përpiqen t'ju vënë në pozitë të vështirë. Rekomandohet të zgjeroni kreativitetin në jetën personale.

AKREPI

Nëse jeni beqar, keni shansin më të mirë të takoni shpirtin binjak. Mos i gëzoni të tjerët nga pamja e jashtme dhe jepini mundësinë t'ju tregojnë anën tuaj më të mirë. Në mbrëmje mund të bëni një de-klaratë mahnitëse dashurie.

SHIGJETARI

Sjellja e disa prej shigjetarëve sot do të jetë misterioze. Do të keni dëshirë të izolo-ni veten ndaj problemeve aktuale dhe debateve të lodhshme. Nëse keni mundë-si, shkoni diku ku mund të qetësoheni plotësisht emocionalisht.

BRICJAPI

Bricjapët duhet të tregohen më bash-këpunues gjatë kësaj të enjte. Mos hezitoni të shprehni me zë të lartë idetë tuaja. Ka gjasë të mbështeteni nga disa persona me influencë. Në përgjithësi, kjo ditë do të kalojë pa telashe.

UJORI

Për pjesën më të madhe të Ujorëve, kjo ditë do të karakterizohet nga cinizmi dhe skepticizmi. Kjo do të ndikojë negativisht tek ata që dëshirojnë të ndërtojnë një ro-mancë të lumtur, ose që kërkojnë ndër nga një person i caktuar.

PESHQIT

Sjellja e Peshqve mund të jetë paksa fëmi-nore gjatë ditës së sotme. Pasiviteti juaj mund të vërë në rrezik suksesin profesional, mbështetjen e një personi të rëndësishëm, ose respektin e dikujt pranë jush. Duhet pat-jetër të jeni më aktiv.

EUROPA LIGË



Elseid Hysaj ishte krah tra jnerit Karlo Anceloti në konferencën për shtyp në vigjilje të ndeshjes së Napolit në Salcburg, ku do të përballtet me Red Bullin vendës. "Duhet të luajmë me përqendrimin e duhur; pa frikë, duhet të jemi të qetë dhe të mbahemi mirë në një stadium të nxehtë. Ndeshjen duhet ta luajmë pa menduar rezultatin e sfidës së parë. E dimë që kanë lojtarë të mirë, e treguan dhe në Napoli

Hysaj: Luaj kudo që të më thotë Anceloti

ndonëse ne fituam 3-0. Duhet të qëndrojmë të qetë. Jemi mirë fizikisht dhe luajmë një futboll të bukur; ndaj na duhet t'i japim vazhdimësi kësaj rruge". Hysaj është gati të luajë kudo që mister Anceloti ta kërkojë, duke parë dhe emergjencën në mbrojtje për skuadrën napoletane, ndërsa ëndërron të shënojë golin e

parë me këtë fanellë. "Jemi 23 lojtarë në skuadër dhe ndonëse mungojnë elementë të rëndësishëm, jemi të gatshëm të sakrifikohejmë për të bërë mirë. Golin e pres prej shumë kohësh, kam kohë që do të jepja gjithcka për një gol, por nuk po vjen. Jam i qetë dhe nëse arrij të shënoj do të isha i lumtur".

SULMUESI KUQEZI

Gashi rrefen sesi e larguan nga Kolorado Rapids

Shkëlzen Gashi u lar sguua pas tre sezonesh nga Kolorado Rapids, skuadër me të cilën firmosi menjëherë pas përfundimit të Euro 2016 të zhvilluar në Francë, ku Gashi ishte pjesë e ekipit të Xhani De Biazit. Por aventura e Gashit me Koloradon përfundoi javën e shkuar dhe vetë sulmuesi tregon për "Denver Post" sesi e larguan nga skuadra. "Nga fillimi i parapërgatitjeve të sezonit kisha leje për tu stërvitur vetëm me skuadrën e të rinjve. Aty e kuptova se klubi dhe unë do të shkonim në rrugë të ndryshme. Megjithatë, edhe në këtë situatë qëndrova si profesionist, madje shënova dy gola në 2 ndeshje", përfundoi Gashi.

Majkëll Ngo dy herë dhe Hasani, sigurojnë fitoren 3-0 për formacionin e Ardian Memës

Tirana dërrmon Laçin dhe sheh nga gjysmëfinalja Bardheblutë triumfojnë pas 3 vitesh me kurbinasit



Tirana kishte prituri plot tre vjet për të gjetur një fitore ndaj Laçit, me kurbinasit që i kishin dominuar në vitet e fundit bardheblutë, por rritja e skuadrës së Ardian Memës në muajt e fundit është e preکشme për këdo në ambientin kryeqytetas. Në Kupën e Shqipërisë, Tirana ka treguar dhe njëherë potencialin e saj, duke dominuar Laçin në lojë dhe në rezultat, për të shpërthyer me tre gola në fraksionin e dytë, që praktikisht u siguron bardhebluve një biletë në gjysmëfinalin, ndonëse janë ende 90 minuta për t'u luajtur në Kurbini. Golin e parë për Tiranën do ta shënojë Majkëll Ngo, me anglezin që shfrytëzon në performancë harkimin e nga e majta të Imamit dhe me kokë thyen Selmanin në minutën e 53-të. Shtatë minutë më vonë, në minutën e 60-të, rritjet e shënojnë 12 minuta më pas, kur lëviz mirë në zonë



dhe me të djathtën thyen Selmanin për herë të dytë në këtë takim. Laçi i dorëzohet furisë bardheblu, që shënon dhe golin e tretë me Edon Hasanin, që finalizon saktë-

sisht një zbritje mjaft të mirë të Ngosë dhe Kobinas. Laçi do të përpiqet të shënojë një gol shprese, por aksionet e bardhezinjve janë të vakëta, me kurbinasit që do të kenë nevojë për një mrekulli për të përmbysur këtë Tiranë në sfidën e kthimit. **MEMA: NUK KA MBRUAR ASGJË** Ardian Mema është i kënaqur me fitoren, por pavarësisht kësaj, ai kërkon të shmangë në maksimum euforinë, ndonëse gjysmëfinalja është më pranë. "Nuk jam shumë i kënaqur, sepse kemi pasur edhe probleme. Gjithsesi rezultati të kënaq. E kishim përgatitur mirë ndeshjen me Laçin, në 2-3

mënyra. Ekipi u shpreh mirë në pjesën e dytë, zbatuan detyrat që u kisha dhënë. Është rezultat i mirë, na jep garanci. Laçi nuk është ekip i dobët, pavarësisht si e gjetëm sot (dje). Besoj se Tirana e ka kontingentin për ta përballuar kampionatin. Lojtarët që nuk kanë luajtur kanë uringë për të luajtur. Në momente që nuk ke arsye të bësh ndërrime, s'ke pse t'i bësh. 2019-ta ka treguar se kemi qenë mirë. Ka pasur edhe zëvendësime, por nëse ka rezultate, nuk ka pse të bëhen ndryshime". **PRENGA: NUK PO LUAJMË FARE MIRË** "Nuk e kisha përgatitur ndeshje për ta prituri Tiranën. Ne kemi kohë që nuk luajmë hiç. Nuk kemi pësuar humb-

je të tilla. Kemi luftuar për topin e parë. Ndërsa sot (dje) nuk bëjmë asgjë. Ishte fitore e merituar e Tiranës. Do jetë shumë e vështirë ta fitojmë Kupën. Luajtëm përballë një ekipi shumë më të mirë se ne. Ka kohë që ne nuk po luajmë hiç. Edhe ndeshjen me Partizanin nuk e di as unë si e morëm. Ndeshja u dominua nga Tirana, nga të gjitha anët. Unë nuk dorëzohem. Ne besojmë ose mendojmë që të ndodhë diçka tjetër. Po nuk ndryshuam, ne ngajmë me ekip veteranësh, jo me ekip seri-oz. Është koha për të ndryshuar diçka. Nuk bëjmë asnjë gjë. Presim minutat të kalojnë. Nuk mund të dilim më mirë".

Dhe janë emra me peshë

Futbolli kolumbian tronditet nga skandalet seksuale te gjyqtarët




thotë se Ruiz kishte në dorë të zgjidhte dhe anëtarët e kryesisë së Shoqatës së Arbitrave, organi që cakton gjyqtarët. Por Perija nuk e lë më kaq dhe sulmon edhe Imer Mashadon, ish-gjyqtar ndërkombëtar dhe

anëtar i Këshillit të Gjyqtarëve së federatës kolumbiane. "Erdhi pranë meje dhe më preku testikujt. Ishte e tmerrshme. Pastaj më kapi nga të ndenjurat dhe nisi të flasë për punën time. Në atë rast nuk e denoncova, por po e bëj tani". Protagonisti tjetër, gjyqtari Karlos Chavez, ka rrëfyer një episod. "Ruiz më ka prekur testikujt kur po dilja nga dushi, duke më thënë se kjo ishte një formë pagese". Në Kolumbi gjatë këtyre ditëve kanë shpërthyer skandale seksuale të mëdha, që kanë përfshirë dhe Kombëtarën e Femrave dhe përfaqësueset e moshave. Por emri i Oskar Ruiz është një emër që nga ato anë ka shumë peshë. Ka gjuvkar në Botërorët 2002, 2006 dhe 2010, ndërsa është zgjedhur në disa raste gjyqtari më i mirë në Amerikën e Jugut.

TELASHE PËR BRAZILIANIN


Shau gjyqtarin, UEFA hap hetim për Nejmar

Nejmar është në prag të stuhisë, stuhi të cilën pritet ta shkaktojë UEFA, që ka hapur një hetim disiplinor për kritikën e forta që braziliani ka bërë për gjyqtarin pas eliminimit të PSG-së në 1/8-at e Ligës së Kampioneve. "është një turp - pat shpërthyer braziliani në rrjetet sociale pas ndeshjes - Pale, vendosin dhe katër vetë që nuk marrin vesh nga futbollit për të parë një aksion në reply, po ikni e...". Sulmuesi i PSG-së, që është i ndaluar në infermierin për një dëmtim të pësuar në fund të muajit janar në këmbën e djathtë, tashmë rrezikon një squalifikim me rinjensin e aktivitetit në kupat e Europës në sezonin e ri.



Një skandal seksual ka përfshirë botën e gjyqtarëve në Kolumbi. Nën akuzë është Oskar Hulan Ruiz, një nga gjyqtarët më të mëdhenj amerikano-jugorë, që mund të jetë përgjegjës për ngacmime seksuale dhe shantazhe ndaj kolegëve të tij. Akuzuesit janë Harold Perija dhe Karlos Chavez, që janë deklaruar viktimat e Ruiz. Fjalët e Perijës nuk lenë vend për interpretime. "Nga viti 2007 e deri kur lashë gjykimin, Ruiz më ka ngacmuar vazhdimisht. Kërkonte të më prekte testikujt dhe hidhte fjalë me nënkuptim. Thoshte se mund të më ndihmonte që të shkoja larg sepse kishte shumë pushtet". Perija është tërhequr prej pak kohësh nga arbitrimi dhe

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Mund të jetë kursimi.
- Ylli i Nostradamus.
- Tamam pa kufij.
- Ross këngëtare.
- I lashtë.
- Është Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
- Kufijtë e lëvizjes
- I ka tek plepi.
- Paguhen për shërbim.
- Fillojnë lejen.
- Kufizojnë trotualet.
- Bëjnë karrierë në parti.
- Thahet me bonifikim.
- Mund të jetë unik një i tillë .
- Preka komik shkordran.
- Fund dhjetori.
- Fillojnë aksionin.
- Ente Operative Tiranë
- Agjenci Ajrorë Durrës.
- Një pjesë e dimensioneve.
- Është përfaqësuesja e Adriam Mutu.

VERTIKAL

- Si i përshtatëshëm.
- Mund të jenë fetare.
- Ai i kuq e ka një huq.
- Pak analogji.
- Është metri i rrobaqepësit.
- Në hyrje të oazit.
- Arte pa re.
- Arthur që qe dramaturg.
- Janë boshte.
- Michelangelo regjisor.
- Mund të bëjë stil të lirë .
- Ishin monedhe te Tobias.
- Është bas me katër tela.
- Pak ofikasitet.
- Është marrëveshje me nota.
- Është babai i Akitit.
- Fillojnë nazet.
- Në krye të kuadrove.
- Është faqe muri.
- Një apendisit i menjëhershëm.
- Kurosawa që qe regjisor.
- Vriten nga espada.
- Është shtet aziatik.
- Edouard piktor.
- Një transporti është kamioni.
- Uni i Freud.
- Një cigan.
- Fundi i një samurai.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Fillojnë panikun.
- Gibson aktor.
- Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
- Mund të jetë trofe.
- Janë vendet si Katari
- Maureen që qe aktore.
- Janë kundërmuese.
- Mund të fitojnë etapa.
- Ushtrinë nga "ola".
- Një thirje
- Janë ministritë.
- Një rrugë në Paris.
- Markë cigareje.
- Është ngjinja.
- Ricciarelli soprano.
- Fillojnë sefte.
- Ente Ekonomike Sarandë.
- Mbyllin një ditë.

VERTIKAL


- Satelit i Jupiterit
- I ka tek Luani.
- Boldi komik italian.
- Është kolana në filma
- Kush e thotë lutet.
- Oxa këngëtare.
- Inicialet e Nolte aktor.
- Është tokë që... fitohet.
- Një... gjermane.
- Një votë në favor.
- Filozofi me eksperimentin e gomarit.
- Në hyrje makinës.
- Fillojnë lehtë.
- Irlanda në Dublin.
- Është edhe ajo e historisë.
- Një pjesë e gamiljeve
- Notat pa kufij.
- Ishin komitë.
- Ka kryeqytet Islamabad.
- Don... i Interpretuar nga Terence
- Mbyllin aktet.
- Janë përmasa.
- Gjysma e lutjes.
- Castellitto aktor.
- Inicialet e Dalí, piktor.
- Tanita këngëtare.
- Është tryzni
- Në hyrje të Europës.
- Janë rrobrot për t'u larë.
- Bën mëza.
- Moreau aktor.
- Janë thika.
- Një pjesë e satelitit.
- Janë teke në sende.
- Pak marramendëse.
- I ka tek zdapi.
- Inicialet e Nolte-s.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

					4		
5		1		4			7
			1	5			3
	4	2					
		5		8	3	1	
			4				6
							8
7				9		5	
8	6						

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	4	1	6	7	2	9	8	3
2	8	7	4	9	3	5	6	1
3	6	9	5	8	1	4	7	2
9	1	3	7	5	6	8	2	4
6	2	8	1	3	4	7	5	9
4	7	5	8	2	9	1	3	6
7	9	4	2	6	5	3	1	8
8	3	6	9	1	7	2	4	5
1	5	2	3	4	8	6	9	7



Argëtim filozofik

- Fjalët i zgjedhin ata që shkruajnë. Kuptimin, ata që lexojnë.
- Kur bëni një zgjedhje, mos mendoni nëse kjo është e drejtë apo e gabuar ... Mendo të jetë vetëm ajo që më të vërtetë ti dëshiron!!!
- Nëse pyetjes tuaj i'u përgjigja me heshtje, do të thotë se jam i sigurt se duke e interpretuar këtë heshtje do të gjeni përgjigjen e duhur dhe jo duke dëgjuar "përgjigjen më të saktë"
- "Të gjithë të mëdhenjtë dikur ishin fëmijë ... por vetëm pak prej tyre e mbajnë mend."

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

T	O	K	A	T	L	U	F	R	A	N	Z	
A	R	E	S	F	I	M	A					
L	I	N	V	E	N	T	I	L	A	T	O	R
L	E	P	E	R	D	I	T	S	H	M	E	
J	T	E	R	R	O	R	I	S	T	E	T	
A	S	A	M	A	R	A	R	E	S			
H	L	O	R	E	N	M	A	R	A	R	E	S
H	A	M	E	S	I	P	A	R	E	T	I	
U	R	I	T	H	S	U	R	R	A	T	I	N
T	I	R	O	I	D	E	T	I	T	V	O	
I	F	N	E	I	T	A	K	A	S	A	R	
M	E	N	T	E	S	H	T	A	T	E		
M	A	H	L	E	R	K	R	N	O	T	A	
I	N	E	S	A	K	O	D	T	E	N		
S	T	R	S	E	N	D	E	R	E	T		
T	E	A	P	E	N	D	I	M	I	A	I	
E	N	M	E	N	D	I	M	I	S	E	G	
R	E	N	A	C	E	T	E	V	E	L	O	
I	T	R	I	Z	A	N	A	K	I	N		
O	A	K	A	T	I	S	A	R	N	A		
Z	A	B	E	L	M	I	M	E	D			
T	O	K	A	L	E	N	D	E	R	A		
T	O	K	A	L	E	N	D	E	R	A		
F	L	A	D	I	N	E	S	T	O	P		

Argëtim filozofik

Thënie të mençura

- Njerëzit gjejnë kohë për ata që duan të gjejnë.
- Njerëzit u shkruajnë dhe u përgjigjen atyre që duan tu flasin. Mos i besoni kurrë dikujt që thotë se ka qënë tepër i zënë. Nëse do të dëshironin të ishin aty me ty , do të ishin patjetër !!
- Mos lejoni të djeshmen të shpenzojë kaq shumë nga e sotmja.
- Më mirë të heshtësh për njëqind gjëra që duhet të flasësh, se sa të flasësh për një gjë që duhet të heshtësh.
- Kushdo që nuk mund të kuptojë heshtjen tuaj, nuk mund të kuptojë as fjalët tuaja.

